



RAPORTI VJETOR

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS

2001

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| LETËR NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM | 2 |
| 1. FJALOR I SHKURTESAVE | 3 |
| 2. PËRMBLEDHJE | 4 |
| 3. EKONOMIA E KOSOVËS NË VITIN 2001 | 5 |
| 3.1 BRUTO PRODHIMI VENDOR, TË HYRAT KOMBËTARE DHË ÇMIMET | 5 |
| 3.2 BILANCI I PAGESAVE | 8 |
| 3.3 POLITIKA FISKALE | 11 |
| 4. BPK-JA DHE AKTIVITETI I SEKTORIT BANKAR NË VITIN 2001 | 14 |
| 4.1 STRUKTURA E BPK-SË | 14 |
| 4.2 OPERACIONET E BPK-SË | 18 |
| 4.2.1 MBIKËQYRJA BANKARE | 18 |
| 4.2.2 MBIKËQYRJA E SIGURIMEVE | 24 |
| 4.2.3 MBIKËQYRJA E PENSIONEVE | 25 |
| 4.3 SISTEMI I KLIRINGUT NDËRBANKAR | 26 |
| 4.4 MENAXHIMI I ASETIVE (MJETEVE FINACIARE) TË JASHTME | 28 |
| 4.5 REZULTATET E AUDITUARA 2001 | 30 |
| 4.6 BANKAT E LICENSUARA | 31 |
| 5. SHTOJCA STATISTIKORE | 32 |
| LISTA E TABELAVE: | 32 |
| LISTA E FIGURAVE | 33 |

I nderuari Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Unioni Monetar Evropian është kompletuar me futjen në përdorim të valutës euro më 1 janar 2002. Euro tani përdoret nga më shumë se 300 milionë njerëz, duke përfshirë kosovarët. Kam kënaqësinë që të falenderoj punën e madhe të të gjithë personelit të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës për të siguruar që kalimi në euro në Kosovë të realizohej pa vështirësi dhe me kohë. Përgatitjet për këtë kalim kanë filluar në fillim të vitit 2001 dhe kanë kërkuar planifikim dhe organizim të konsiderueshëm.

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës është një institucion i ri dhe ende është duke pësuar ndryshime organizative. Kur BPK-ja u themelua në nëntor të vitit 1999, në Kosovë nuk funksiononte asnjë bankë tjetër. Nevoja për të siguruar shërbime bankare komerciale ka imponuar funksionimin e BPK-së nëpërmjet një rrjeti të gjerë filialash për të shërbyer të gjitha komunitetet. Gjatë vitit 2001, meqë sektori bankar komercial u zhvillua më shumë, BPK-ja i zgjeroi përgjegjësitë e saja të mbikëqyrjes dhe licensimit në sektorin financiar dhe u përqëndrua në zhvillimin e sektoreve të sigurimit dhe pensioneve.

Në vitin 2001, vazhduan programet e trajnimit për ngritjen e aftësive profesionale të personelit në kuadër të të gjitha funksioneve të BPK-së duke i kushtuar rëndësi të veçantë funksioneve mbikëqyrëse dhe rregullative. Personeli i BPK-së ka marrë pjesë në programet e trajnimit që janë mbajtur brenda dhe jashtë vendit, disa prej të cilave ishin financuar nga donatorët. Përparim i madh është arritur edhe në ngritjen e aftësive të personelit vendor dhe trajnimi vazhdon të jetë një ndër prioritetet më të larta. Megjithatë, shumëçka ende mbetet për t'u bërë.

Kam kënaqësinë t'ua paraqes Raportin Vjetor 2001 të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës.

Chaiha Kim Rhee
Drejtor i Përgjithshëm

1. FJALOR I SHKURTESAVE

| | |
|--------------|---|
| BPK | Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës |
| AQF | Autoriteti Qendror Fiskal |
| ShDK | Shërbimi Doganor i Kosovës |
| IJD | Investimet e Jashtme Direkte |
| RFJ | Republika Federative e Jugosllavisë |
| BPV | Bruto Prodhimi Vendor |
| PKB | Prodhimi Kombëtar Bruto |
| SNK | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit |
| SKN | Sistemi i Kliringut Ndërbankar |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| KKPN | Komiteti Këshillëdhënës i Pagesave Ndërbankare |
| BKK | Buxheti i Konsoliduar i Kosovës |
| AMK | Agjencioni i Mirëbesimit të Kosovës |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| IMF | Institucionet Mikro Financiare |
| PIP | Programi i Investimeve Publike |
| NPSH | Ndërmarrje në Pronësi Shoqërore |
| ESK | Enti Statistikor i Kosovës |
| UNMIK | Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë |
| USAID | Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar |

2. PËRMBLEDHJE

Ekonomia e Kosovës vuajti me dekada nga mospërfillja ekonomike dhe mungesa e investimeve. Ajo ishte e dobët madje edhe para konfliktit të vitit 1999, i cili shkatërroi ose ashpër dëmtoi objektet e banimit, bujqësinë dhe infrastrukturën. Si rezultat i kësaj, prodhimi industrial dhe bujqësor u zvogëlua në mënyrë të theksueshme. I vlerësuar nga ana e Bankës Botërore, BPV-ja për kokë banori, në vitin 1995, ishte \$400, dhe si i tillë ishte dukshëm më i ulët në Evropë. Në vitin 2001 BPV-ja arriti në \$900, por vazhdoi të mbetet prapa nivelit të arritur në vende të tjera të rajonit, që kanë dalë nga konflikti.

Ekonomia gjendet ende në fazën fillestare të zhvillimit. Mbështetja emergjente e pasluftës për Kosovën ishte e fokusuar në krijimin e paqës dhe rendit, në ofrimin e ndihmës humanitare, vendosjen e administratës civile, asistimin në rindërtimin e shtëpive dhe rifillimin e veprimit të ekonomisë. Ekonomia e Kosovës, në vitin 2001, vazhdoi të mbështetet në participimin e donatorëve të jashtëm në projektet investive. Në fund të vitit 2001, Bashkimi Evropian ishte dukshëm donatori më i madh dhe merrte pjesë më 65% të zotimeve të tërësishme. Ndryshimet dhe zhvillimet në ekonominë lokale ndikuan që, në vitin 2001, rritja reale e BPV-së të jetë afër 11%. Sidoqoftë, papunësia mbetet problemi kryesor i popullsisë kryesisht të re të Kosovës.

Ndër sukseset e mëdha të pas konfliktit ishte ndërtimi i sistemit bankar efikas dhe të shëndoshë, i cili mbështetet në parimet më të mira të veprimeve bankare ndërkombëtare. Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK), i krijuar, në nëntor të vitit 1999, nga ana e UNMIK-ut dhe sipas Rregullores 1999/20, veprroi, në tërë Kosovën, përmes zyrës së tij qendrore në Prishtinë dhe përmes 22 filialave dhe nënfilialave të tij. Rrjeti i filialave të BPK-së, në vitin 2001, vazhdoi të ofrojë shërbime të pagesave, shërbime të depozitimit bankar, pagesa vendore dhe ndërkombëtare dhe shërbime të kolektimit të taksave dhe pagesave tjera. Në të njëjtën kohë, funksioni i licencimit dhe mbikëqyrjes financiare u rrit në mënyrë të theksueshme.

3. EKONOMIA E KOSOVËS NË VITIN 2001

3.1 BRUTO PRODHIMI VENDOR, TË HYRAT KOMBËTARE DHË ÇMIMET

Ekonomia e Kosovës është ende në fazën fillestare të zhvillimit. Të dhënat disponuese flasin për një rritje reale të aktivitetit ekonomik krahasuar me vitin 2000. Brenda shkallës së inflacionit të çmimeve prej 11 %, Bruto Prodhimi Vendor (BPV)¹, në vitin 2001, u rrit afër 11%. Përkundër rritjes domethënëse prej viti në vit për 23.5% (në euro: 1,747 milion), BPV-ja në vitin 2001 ishte ende dukshëm nën nivelin e duhur për plotësimin e nevojave të ekonomisë së Kosovës.

Ekonomia e Kosovës ishte e brishtë madje edhe para konfliktit dhe kjo si pasojë e ngecjes ekonomike me dekada, pastaj mospërfilljes dhe investimeve të dështuara e programeve ekonomike eksploatuese. Bruto Prodhimi vendor për kokë banori i vlerësuar nga Banka Botërore, në vitin 1995, ishte 400 \$, pra dukshëm më i ulët në Evropë. Konflikti i vitit 1999 dukshëm e dëmtoi ekonominë e Kosovës. Pjesa dërmuese e fondit banesor, bujqësisë dhe infrastructures u shkatërrua ose dukshëm u dëmtua gjatë këtij konflikti. Si pasojë e kësaj, prodhimi industrial dhe bujqësor shënoi zvogëlim drastik.

BPV-ja për kokë banori në vitin 2001 ishte 900 \$ amerikan. Ky nivel është dukshëm nën atë të shënuar në vende të tjera përfshirë këtu edhe vendet e rajonit që kanë dalë nga konflikti : Bosna dhe Hercegovina (\$1.109), Shqipëria (\$1.218), Jugosllavia (\$1.261), Maqedonia (\$1.674), Bullgaria (\$1.686), Rumania (\$1.772), Kroacia (\$4.625) dhe Sllovenia (\$9.443).

Prodhimi Kombëtar Bruto (PKB)², në vitin 2001, e tejkaloi BPV-në për 687 milion euro. Krahasuar me vitin 2000, vërehet rënie e dukshme (nga 163% në 146%) e konsumit në përbërjen e BPV-së. Pjesëmarrja e ndihmës së jashtme (grantet e donatorëve për financimin e buxhetit dhe ndihmë në rindërtim) në BPV ka rënë nga 96% në 76% krahasuar me vitin paraprak. Sidoqoftë, vlera e tërësishme monetare e asistencës së jashtme, në vitin 2001,

¹ Bruto Prodhimi Vendor (BPV) përfshin shërbimet dhe mallrat finale të prodhuara brenda kufinjve të Kosovës nga faktorët vendor dhe të jashtëm (puna dhe kapitali) dhe të shitura në treg gjatë vitit plus të mirat konsumuese nga prodhimi vetanak (ekonomia naturale).

² Prodhimi Kombëtar Bruto (PKB) përfshinë shërbimet dhe mallrat finale të prodhuara nga faktorët vendor brenda kufinjve të Kosovës dhe të shitura në treg gjatë vitit plus të hyrat nga puna e kosovarëve të punësuar në Kosovë si dhe nga ana e donatorëve ndërkombëtar dhe dërgesat e transferuara gjatë vitit nga ana e kosovarëve të punësuar jashtë. Të Hyrat në Dispozicion të Rregulluara (HDRr) përfshijnë gjithsej të hyrat monetare në dispozicion të njësive institucionale kosovare (ekonomitë familiare, ndërmarrjet, qeverinë dhe OJQ-të) të zgjeruara për transferet në mallra siq janë ndihma në rindërtimin e shtëpive, ndihma në ushqim dhe të hyrat e imputuara nga pronarët që posedojnë vendbanime.

mbeti gati e pandryshuar: 1.329 milion euro. Pjesëmarrja e importit në BPV, në këtë periudhë, ra nga 145% në 117%. Prandaj, në këtë fazë të zhvillimit ekonomik të Kosovës nuk befason aspak fakti se 60% e BPV-së u shpenzua në importimin e mallrave dhe shërbimeve. Kjo thekson të mbështeturit e ekonomisë së Kosovës si në import ashtu edhe në asistencë të jashtme.

Tabela 1.

INDIKATORË TË ZGJEDHUR MAKROEKONOMIK

| | Njësia | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 |
|---|------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| BPV | Mil. euro | 1.414 | 1.747 | 1.990 | 2.163 | 2.339 | 2.530 |
| BPV, shkalla e rritjes nominale | % | | 23,5 | 14,0 | 8,7 | 8,2 | 8,1 |
| BPV, shkalla e rritjes reale | % | | 11,0 | 7,0 | 4,5 | 4,5 | 5,5 |
| Shkalla e inflacionit | % | - | 11,3 | 6,5 | 4,0 | 3,5 | 2,5 |
| BPV/për kokë banori | euro | 798 | 941 | 1,051 | 1,122 | 1,196 | 1,284 |
| Konsumi | Mil. euro | 2.317 | 2.572 | 2.809 | 2.834 | 2.785 | 2.803 |
| Konsumi/BPV | % | 163 | 147 | 141 | 131 | 112 | 110 |
| Investimet | Mil. euro | 959 | 946 | 871 | 706 | 575 | 585 |
| Nga të cilat PIP | Mil. euro | 628 | 588 | 411 | 280 | 220 | 200 |
| Investimet/BPV | % | 68 | 54 | 44 | 33 | 24 | 231 |
| Eksporti i mallr. & shërb. jofaktoruese | Mil. euro | 148 | 231 | 247 | 244 | 220 | 225 |
| Importi i mallr. & shërb. jofaktoruese | Mil. euro | -2.051 | -2.050 | -1.977 | -1.661 | -1.281 | -1.124 |
| Importi i mallrave | Mil. euro | -1.116 | -1.058 | -1.246 | -1.121 | -926 | -860 |
| Importi i shërb.jofaktoruese | Mil. euro | -935 | -992 | -731 | -540 | -355 | -264 |
| Nga të cilat: dërgesat nga jashtë | Mil. euro | 472 | 524 | 526 | 507 | 441 | 437 |
| LIRr pa grantet | Mil. euro | -1.254 | -1.132 | -1.072 | -803 | -549 | -412 |
| LIRr para granteve/BPV | % | -89 | -65 | -54 | -37 | -23 | -16 |
| Grantet (AJ) | Mil. euro | 1.336 | 1.290 | 1.032 | 794 | 528 | 386 |
| PIP | Mil. euro | 628 | 588 | 411 | 280 | 220 | 200 |
| Grante buxhetore | Mil. euro | 102 | 77 | 10 | 25 | 15 | 10 |
| Ndihmë tjetër (nga të cilat, shërbimet e importuara dhe të mbështetura nga donatorët) | Mil. euro | 570 | 661 | 602 | 484 | 293 | 176 |
| Balansi i LIRr pas granteve | Mil. euro | 82 | 197 | -40 | -9 | -21 | -26 |
| Balansi i LIRr pas granteve/BPV | % | 6 | 11 | -2 | 0 | -1 | -1 |
| Investimet e Jashtme Direkte (IJD) | Mil. euro | 0 | 5 | 10 | 30 | 40 | 45 |
| Eksporti i mallrave & shërb.jofak./ BPV | % | 10 | 13 | 12 | 11 | 9 | 9 |
| Importi i mallrave & shërb.jofak. / BPV | % | -145 | -117 | -99 | -77 | -55 | -44 |
| Dërgesat e punëtorëve nga jashtë / BPV | % | 33 | 30 | 26 | 23 | 19 | 17 |
| Asistenca e jashtme / BPV | % | 94 | 74 | 52 | 37 | 23 | 15 |
| Investimet e jashtme direkte / BPV | % | 0 | 0 | 1 | 1 | 2 | 2 |
| PKB | Mil. euro | 2.063 | 2.434 | 2.648 | 2.777 | 2.852 | 3.016 |

Burimi: Vlerësimet dhe parashikimet e zyrtarëve të FMN-së dhe të Njesisë Makroekonomike të AQF-së.

Tabela 2

INDEKSI I ÇMIMIT TË KONSUMIT (IÇK), total, 2000-Ç1 – 2001-Ç4

| | Indeksi i cmimit të konsumit | | |
|-------------|------------------------------|----------------------|--------------------|
| | Jan 2001=100 <i>1</i> | Periudha <i>2</i> | Vjetor <i>3</i> |
| 2000 | 92.72 | | |
| 2001 | 102.89 | 10.97 | 10.97 |
| 2000 | | | |
| Ç1 | 91.93 | | |
| Ç2 | 91.04 | -0.97 | |
| Ç3 | 92.59 | 1.70 | |
| Ç4 | 95.32 | 2.95 | |
| 2001 | | | |
| Ç1 | 100.51 | 5.45 | 9.34 |
| Ç2 | 102.66 | 2.14 | 12.76 |
| Ç3 | 103.50 | 0.81 | 11.79 |
| Ç4 | 104.88 | 1.33 | 10.03 |

Burimi: Ministria për Ekonomi dhe Financa, Njësia Makroekonomike

Indeksi i konsumit, në vitet 2000-2001, u rrit me një shkallë mesatare për 2-3 % për çerek ose 10 % në vit. Rritja më e shpejtë e çmimeve të konsumit u shënuar në çerekun e parë të vitit 2001 dhe krahasuar me çerekun e katërt të vitit 2000 kjo rritje ishte 5.45 %. Gjatë vitit 2000 (Janar – Dhjetor 2000), rritje më të larta ndodhën te çmimet e pemëve dhe perimeve dhe atë 27.1 %, pastaj për banim dhe mobilje 23.0% dhe prodhime të qumështit 19.7%. Në vitin 2001 (Dhjetor 2000 – Dhjetor 2001), rritje më të larta të çmimit patëm të pemët dhe perimet 19.5 %, mishi dhe peshku 18.4% dhe banimi e mobiljet 14.2%.

Është interesant se prodhimet me rritje të lartë të çmimit janë ose prodhime lokale (“të patregtueshme”) ose “të tregtueshme” të cilat i takojnë kategorisë së “importeve konkurruese”, p.sh. mallrat të cilat janë të prodhuara në sasi relativisht të mëdha në Kosovë (për të cilat pjesëmarrja e importit në shitjet e tërësishme në Kosovë është relativisht e ultë); të gjitha këto nuk janë të fuqisë punëtore intensive. Në të njëjtën kohë, çmimet e shumicës

¹ Çmimet mesatare për periudhën e dhënë kohore (viti, çereku dhe muaji), Janar 2001=100

² Indeksi i çmimeve prej periudhës në periudhë (viti me vit, çereku me çerek dhe muaji me muaj) = ndryshimet në çmim të llogaritura për periudha të njëpasnjëshme, përqindje.

³ Ndryshimet vjetore të çmimit = ndryshimi në shkallën mesatare të çmimit për periudhën e dhënë kohore i krahasuar me periudhën e njëjtë kohore nga viti paraprak, përqindje.

së mallrave “të tregtueshme jokonkurruese” (p.sh. ato që kryesisht janë të importuara: siç janë kafeja, çaji, pijet alkoolike, cigaret, sapuni, shamponi, detergjentet, rrobot, veshmbathja, frigoriferët dhe televizorët) dhe çmimet e shërbimeve të karakterit intensiv të punës (të patregtueshme, siç janë ushqimi në restorante, riparimi i paisjeve shtëpiake, riparimi i veturave) kanë mbetur stabile dhe madje kanë shënuar rënie.

3.2 BILANCI I PAGESAVE

Ekonomia e Kosovës në shkallë të konsiderueshme mbështetet në dërgesat nga jashtë, në asistencën e jashtme dhe në import. Këta faktorë e përcaktojnë zhvillimin e bilancit të pagesave. Pjesëmarrja e *dërgesave të punëtorëve nga jashtë* (diaspora kosovare) në BPV, në vitin 2001, mbeti thuaja stabile në nivelin prej 30% të BPV-së. Kjo tregon se emigracioni kosovar luan rol kyç në zhvillimin ekonomik, social dhe politik të Kosovës.¹ Dërgesat nga diaspora kanë kontribuar dukshëm në sigurimin e ekzistencës së popullsisë kosovare dhe gati 80% e familieve marrin dërgesa mujore midis \$250-\$500. Këto dërgesa, së bashku me *asistencën e donatorëve* dhe kursimet vendore, kanë luajtur rol kryesor në ringjalljen e ekonomisë kosovare. Transferët nga diaspora arritën në 524 milion euro, në vitin 2001, dhe sipas karakterit të tyre kryesisht ishin të orientuar në konsumin personal dhe rindërtimin e shtëpive private.

| Tabela 3 | | | | | |
|----------------------------------|-----------|-----------|-----------|---------|-----------|
| ZOTIMET E DONATORËVE PËR KOSOVËN | | | | | |
| 1999 | | 2000 | | 2001 | |
| Zotuar | Shpenzuar | Zotuar | Shpenzuar | Zotuar | Shpenzuar |
| 304,122 | 165,961 | 1,138,378 | 651,303 | 535,982 | 578,905 |

Mijëra euro

Burimi: Njësia e Koordinimit të Donatorëve (MFE/DPE)

Në përfundim të vitit 2001, del se donatorët janë zotuar në shumë rreth 2.0 miliardë euro dhe kanë shpenzuar 1.4 miliardë euro (afër 1.6 miliardë euro nëse përfshijmë edhe mbështetjen buxhetore). Ndër donatorët kryesor të Kosovës paraqitet Bashkimi Evropian

¹ E kaluara ekonomike dhe politike e Kosovës tregon për tri valë kryesore të emigrimit. Vala e parë – kryesisht njerëz të pakualifikuar, të paarsimuar dhe nga viset rurale të Kosovës – e lëshoi Kosovën në fund të viteve të gjashtëdhjetë dhe në fillim të viteve të shtatëdhjetë. Vala e dytë – shqiptarë nga viset urbane të Kosovës, kryesisht më mirë të edukuar dhe më të kualifikuar – e lëshoi Kosovën gjatë viteve të tetëdhjetë dhe në fillim të viteve të nëntëdhjetë. Vala e tretë e azilkërkuesve dhe refugjatëve u largua nga Kosova në rrethana tmerruese gjatë konfliktit të viteve 1998-99.

pjesëmarrja e të cilit në zotimet e tërësishme, në fund të vitit 2001, ishte rreth 65%, ndërsa pas tij si donatorë më zemërgjerë vijnë Shtetet e Bashkuara, Zvicra, Japonia, Kanadaja dhe Banka Botërore.

Investimet kapitale në Kosovë mbetën në nivel të 55% të BPV-së. Kjo mund të jetë një e dhënë dukshëm çorientuese kur kihet parasysh fakti se ekonomia e Kosovës është lartë e subvencionuar nga jashtë.¹ Prandaj, krahasimi më i përshtatshëm dhe më real është ai i pjesëmarrjes së investimeve në PKB, pjesëmarrje kjo e cila në vitin 2001 ishte 39%. Për shkak të infrastrukturës ekzistuese dhe menaxhmentit të disponueshëm të dobët si dhe bazës së ultë të shkathtësive të fuqisë punëtore, kjo është më afër shkallës në të cilën ekonomia lokale është e aftë të absorbojë investimet kapitale. Rreth 60% e shumës prej 968 milionë eurosh të investuara në Kosovë u shpenzuan në programin e investimeve publike (PIP). Kjo, lidhur me projektet investive, nënvizon varshmërinë e vazhdueshme të ekonomisë së Kosovës nga donatorët e jashtëm.

Faza fillestare e mbështetjes emergjente pas konfliktit për Kosovën ishte e fokusuar në krijimin e paqës dhe rendit, sigurimin e sigurisë personale të banorëve, ofrimin e ndihmës humanitare, ngritjen e administratës civile, lehtësimin e kthimit të refugjatëve në shtëpitë e tyre, ndihmën në rindërtimin e shtëpive dhe rifillimin e veprimit të ekonomisë. Në këtë fazë, pjesa dërmuese e aktiviteteve investive (energja elektrike, uji, shërbimet e komunikimit, etj.) ishin të financuara dhe të administruara nga donatorët.

Ndër sukseset e mëdha të pas konfliktit ishte edhe ndërtimi i sistemit bankar efikas e të shëndoshë dhe të bazuar në parimet më të mira të bankingut ndërkombëtar. Me shtatë bankat komerciale të licencuara dhe të mbikëqyrura nga ana e BPK-së, sektori financiar u bë një partner dhe mbështetës i zhvillimit ekonomik gjithëpërfshirës të Kosovës. Krahas ofrimit të pagesave me të gatshme dhe shërbimeve të grumbullimit, bankat komerciale, gradualisht, zhvilluan programet e kreditimit të bizneseve dhe individëve. Institucionet mikro financiare ishin ndër të parat në ofrimin e mbështetjes për komunitetet dhe bizneset dhe atë në formë të kredive për zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve tjera.

¹ Produkti Kombëtar Bruto përbënte përafërsisht 139% të BPV-së.

Ekonomia e Kosovës vazhdon të varet nga importi dhe si rezultat i kësaj, edhe në vitin 2001, ajo shënon një deficit të lartë në këmbimi me botën e jashtme. Bazuar në të dhënat e ofruara nga Shërbimi Doganor i Kosovës fitojmë një pasqyrë të qartë të importit sipas strukturës gjeografike dhe llojit të mallrave të importuara.

Tabela 4

TREGTIA E JASHTME: IMPORTI SIPAS MALLRAVE

| | Total importi komercial | Total importi (BRICO) | Ushqim | Veshë- mbathje | Karburantet | Plastikë & druri | Material ndërtimor | Metal | Makineri | Paisje transporti | Tjerë |
|-------------|-------------------------------|-----------------------------|--------------|-------------------|-------------|---------------------|-----------------------|-------------|-------------|----------------------|-------------|
| 2000 | 372.2 | 1,055.0 | 69.4 | - | 46.3 | 37.1 | 15.1 | 19.6 | 23.0 | - | 845.0 |
| 2001 | 659.8 | 539.4 | 165.0 | 15.7 | 89.1 | 73.7 | 26.2 | 43.0 | 41.0 | 4.5 | 81.7 |

Vërejtje: Total Importi Komercial – vlera e importit të tatuëshëm
 Total Importi – i dokumentuar nga baza e shënimeve BRICO. Viti 2000 dhe 2001 nuk përfshinë dërgesat nga/nëpërmjet Serbisë.
 Viti 2001 nuk përfshinë mallrat e liruar nga taksat dhe të sjellura në Kosovë nga ana e UNMIK-ut, KFOR-it, donatorëve tjerë ndërkombëtar, misionet diplomatike, OJQ-të me status publik përfitues.
 Burimi: AQF/MFE: Monitori Makroekonomik, Korrik 2002

Përderisa participimi i lartë i importit të petrolit (13.5%) dhe produkteve prej plastike dhe druri (11.2%) është i kuptueshëm, atëherë, dëshpërues mund të jetë fakti se importi i ushqimit zë vend kaq dominant (25%) në bilancin tregtar të një ekonomie përndryshe agrare.

Shenjat e para pozitive në bilancin tregtar të Kosovës u shfaqën në vitin 2000 dhe 2001. Përafërsisht, pas shkatërrimit total të ekonomisë lokale dhe mungesës complete të kapacitetit eksportues, viti 2000 dhe 2001 tregojnë për kthimin e eksportit në listat e bilancit tregtar të Kosovës. Pjesëmarrje më të lartë në eksport kanë produktet e plastikës dhe të drurit 34%, ndërsa produkte metalike dhe pjesë vijnë në vendin e dytë me 30.5%.

Tabela 5

TREGTIA E JASHTME: EKSPORTI SIPAS MALLRAVE

| | Total | Ushqim | Plastikë & druri | Veshë- mbathje | Material ndërtimor | Metal & pjesë | Paisje elektrike | Paisje transporti | Tjerë |
|-------------|--------------|-------------|---------------------|-------------------|-----------------------|------------------|---------------------|----------------------|-------------|
| 2000 | 18.68 | 5.27 | 7.69 | 0.41 | 0.02 | 3.76 | 1.06 | 0.25 | 0.23 |
| 2001 | 10.63 | 1.49 | 3.61 | 0.11 | 0.07 | 3.25 | 1.55 | 0.14 | 0.42 |

Burimi: AQF/MFE: Monitori Makroekonomik, Korrik 2002

Aplikimi i TVSH-së në korrik të vitit 2001, i cili zëvendësoi tatimin në shitje, dhe zëvendësimi i ndihmës humanitare me import komercial, krijoi një strukturë të re gjeografike të importit. Shtetet e Ballkanit u bënë partnerët kryesorë tregtar të Kosovës në vitin 2001. Faktorët historik, gjeografik dhe ekonomik shpjen deri të një rritje e fortë e këtyre marrëdhënieve tregtare.

Përafërsisht 62% e tërë importit kosovar vjen nga Maqedonia, Turqia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Bullgaria. Maqedonia mbetet dukshëm partneri më i madh tregtar i Kosovës. Ajo vazhdon të gëzojë kushtet e tregtisë më të favorizuar, kështu që në mallrat që në Kosovë vijnë nga Maqedonia aplikohet vetëm 1% taksë doganore. Marrëveshja e tregtisë së lirë midis Maqedonisë dhe RFJ-së ka një ndikim evident si në importin ashtu edhe eksportin e Kosovës. Certifikatat maqedonase mbi origjinën e mallit shpeshherë mbulojnë mallrat të cilat kanë origjinë nga shtetet tjera. Kjo ka efekt deformues në tregtinë e jashtme të Kosovës dhe është konsideruar si një burim i evazionit fiskal.

Tabela 6

**TREGTIA E JASHTME: IMPORTI I MALLRAVE SIPAS
VENDNGARKIMIT**

Milliona euro

| | Total importi komercial | Total importi (BRICO) | Shqipëria | Kroacia & BeH | Bullgaria | UE & Zvicra | Maqedonia | Mali i Zi | Turqia | Tjerë |
|------|-------------------------------|-----------------------------|-----------|---------------------|-----------|----------------|-----------|-----------|--------|-------|
| 2000 | 372 | 1,055 | 21 | 32 | 85 | 95 | 349 | 169 | 106 | 198 |
| 2001 | 660 | 539 | 29 | 20 | 35 | 161 | 148 | 50 | 75 | 22 |

Vërejtje: Të dhënat për vitin 2001 nuk përfshijnë dërgesat nga/nëpërmjet Serbisë

Burimi: AQF/MFE: Monitori Makroekonomik, Korrik 2002

3.3. POLITIKA FISKALE

Aktualisht, Kosova gëzon përfitimet nga një sistem legal tatimor i thjeshtë dhe efikas dhe nga një treg i cili është shumë më i hapur se shumica e tregjeve në regjion. Natyrisht, do të jetë e nevojshme që korniza fiskale të modifikohet konform aktualitetit dhe në pajtim me ecuritë në ekonominë lokale. Për këtë arsye, modifikimet, parimisht, kanë për objektiv zgjerimin e bazës tatimore dhe përmirësimin e efikasitetit të grumbullimit si dhe, në të njëjtën kohë, zvogëlimin gradual të barrës prej kufirit kah ekonomia vendore.

Tabela 7.

PJESËMARRJA E QEVERISË NË EKONOMINË E KOSOVËS

| | (në % të BPV) | | |
|---|---------------|-------------|--------------|
| | 2000 | 2001 | 2002 (vler.) |
| Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) shpenzimet (përfshirë komunat) | 15.7 | 16.0 | 27.0 |
| BKK + Programi i Investimeve Publike (PIP) | 60.1 | 49.6 | 47.6 |
| BKK + PIP + Shërbimet e Qeverisë të mbështetura nga donatorët | 100.4 | 87.4 | 77.9 |

Burimi: MFE, AQF dhe vlerësimet e zyrtarëve të FMN-së

Të hyrat në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK) tejkaluan parashikimet buxhetore në një shkallë të lartë si në vitin 2000 ashtu edhe në vitin 2001, dhe si duket këtë do ta bëjnë sërish edhe në vitin 2002, duke arritur kështu në 20.5% të BPV-së. Pjesëmarrja e shpenzimeve buxhetore të përgjithshme në BPV ishte relativisht e ultë në vitin 2001 dhe atë vetëm 16.0%. Mirëpo, kur kësaj i shtojmë shumën nga programi i investimeve publike (i financuar tërësisht nga grantet e donatorëve), del se shpenzimet publike mbërrijnë në 49.6% të BPV-së.

Të hyrat nga taksat kufitare ishin burimi kryesor i të hyrave në BKK dhe, në vitin 2001, kishin një pjesëmarrje në të hyrat e tërësishme buxhetore prej 61%. Në korrik të vitit 2001, tatimi në shitje u zëvendësua me TVSH-në, gjë kjo që mëtutje kontribuoi me një rritje prej 22.9% në të hyrat e tërësishme buxhetore të Kosovës.

Tabela 8.

SEKTORI FISKAL: BUXHETI I PËRGJITHSHËM – TË HYRAT NGA TATIMET, TË HYRAT NGA JO TATIMET DHE MBËSHTETJA E BUXHETIT NGA ANA E DONATORËVE

| | <i>Milliona euro</i> | | | | | | | | |
|------|----------------------|-------------------|---------|----------|----------|---------------------------------------|---|-------------------------------------|-----------------------------|
| | GJITHSEJ | Të hyrat tatimore | | | Gjithsej | Të hyrat jotatimore | | | Mbësht. buxhetore donatorët |
| | | Gjithsej | Vendore | Kufitare | | Dokumente udhëtimi: kuotë participimi | Rexhistrimi veturave: kuotë participimi | Gjyqet & komunat: kuotë participimi | |
| 2000 | 228.9 | 121.7 | 6.5 | 115.2 | 4.8 | n/a | n/a | n/a | 102.3 |
| 2001 | 342.0 | 249.7 | 41.0 | 208.7 | 15.9 | 3.73 | 8.43 | 3.77 | 76.3 |

Burimi: AQF/MFE: Monitori Makroekonomik, Korrik 2002

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore në vitin 2001 arritën në 228.2 milion euro ose 13% të BPV-së. Shpenzimi i përgjithshëm buxhetor u rrit diku afër 12% midis vitit 2000 dhe 2001. Faktori kryesor pas kësaj rritjeje ishte rritja e shpenzimeve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të cilat midis viteve 2000 dhe 2001 u rritën përafërsisht 59%.

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale kanë qenë marrësit më të mëdhenj të fondeve nga buxheti i përgjithshëm (45.4% të shpenzimeve të tërësishme buxhetore). Ekonomia dhe sektorët tjerë – derivatet e naftës dhe energjia, resurset natyrore, transporti dhe komunikimet dhe artikuj të paklasifikuar, kishin pjesëmarrje prej 15.33% në konsumin publik.

Tabela 9.

SEKTORI FISKAL: BUXHETI I PËRGJITHSHËM - SHPENZIMET SIPAS FUNKSIONEVE TË QEVERISË

| | | <i>Miliona euro</i> | | | | | | | |
|-------------|-----------------|--------------------------|------------------------|-------------|-------------|-------------------|---------------------|-----------------------|------------------|
| | Gjithsej | Shërbimet e përgjithshme | Rendi publik & siguria | Arsimi | Shëndetësia | Mirëqenia sociale | Banimi & komuniteti | Rekreacioni & kultura | Ekonomia & tjerë |
| 2000 | 203.8 | 11.6 | 16.4 | 56.8 | 33.0 | 32.2 | 10.0 | 2.3 | 41.5 |
| 2001 | 228.2 | 11.7 | 10.8 | 23.6 | 59.4 | 44.2 | 39.1 | 4.5 | 35.0 |

Burimi: AQF/MFE: Monitori Makroekonomik, Korrik 2002

Në vitin 2001, Kosova arriti një suficit buxhetor prej 133.7 milion euro.

Tabela 10.

SEKTORI FISKAL: BILANCI BUXHETOR RRJEDHËS

| | | <i>Miliona euro, fundi i periudhës</i> | | |
|-------------|--|--|----------------------|----------------------------|
| | | Të hyrat rrjedhëse | Shpenzimet rrjedhëse | Bilanci buxhetor rrjedhës* |
| 2000 | | 219.6 | 199.7 | 19.9 |
| 2001 | | 341.9 | 228.2 | 133.7 |

*Të dhënat përfaqësojnë bilancin rrjedhës të parasë së gatshme të mbajtur në Fondin e Konsoliduar të Kosovës pranë Thesarit Qendror.

Burimi: AQF/MFE: Monitori Makroekonomik, Korrik 2002

4. BPK-JA DHE AKTIVITETI I SEKTORIT BANKAR NË VITIN 2001

4.1. STRUKTURA E BPK-SË

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës është themeluar me 15 Nëntor 1999 në pajtueshmëri me parimet dhe vendimet e Misionit të Administrimit të Përkoheshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, respektivisht me Rregullorën 1999/20 “Per Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës” (me tutje e plotësuar nga Rregullorja 2001/24)

Sipas Nenit 5 të Rregullorës, objektivat kryesore të BPK-së janë :

- të zhvillojë sistemin efikas dhe të sigurtë për pagesat në vend, dhe
- të zhvillojë likuiditetin, aftësinë paguese dhe funksionimin efikas të sistemit financiar të bazuar në treg stabil, duke përfshirë rregullimin e standardeve për veprimtarinë e bankave, kompanive të sigurimit dhe institucioneve të tjera financiare.

Sipas Nenit 6 të Rregullorës, BPK është autorizuar dhe me kompetenca specifike:

- nën udhëheqjen e Zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Rindërtim Ekonomik dhe Zhvillim, të rekomandojë direktiva të përgjithshme në kuadër të politikës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në fushat që përbëjnë përgjegjësinë e BPK-së;
- të formulojë dhe implementojë masat për pagesat dhe sistemet e rregullimit për transaksionet në monedhë vendore dhe të huaj në Kosovë si dhe të mbikëqyrë dhe të rregullojë këtë sistem;
- të posedojë dhe operojë me një ose më shumë sisteme të pagesave;
- të veprojë si bankë e Autoritetit Qendror Fiskal dhe të ofrojë këshilla financiare me kërkesë të tij;

- të veprojë si faktor fiskal I Autoritetit Qendror Fiskal
- të mbaj depozitat e bankave, të Autoritetit Qendror Fiskal, dhe të entiteteve të tjera në monedha të huaja;
- të sigurojë sasi të mjaftueshme të banknotave dhe monedhave të vogla për rregullimin e transaksioneve me para të gatshme;
- të mbaj një vend për ruajtjen e sigurtë të të hollave dhe letrave me vlerë;
- të licensojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare;
- të mbikëqyrë dhe rregullojë agjencitë për këmbimin e valutave të huaja; dhe
- të kryejë rregullisht analiza ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, t'i bëjë publike rezultatet e tyre dhe, në bazë të analizave të tilla, të bëjë propozime për masat e reja në këtë fushë nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Bordi Drejtues, menaxhmenti dhe stafi punues formojnë organizimin e BPK-së. Bordi Drejtues formulon politikat për operacionet e BPK-së dhe mbikëqyr implementimin e tyre. Stafi i BPK-së i raporton, jo më pak se dhjetë herë çdo vit, Bordit Drejtues mbi udhëheqjen e operacioneve dhe politikave të tij, mbi rregullsinë e sistemit financiar, dhe mbi gjendjen e tregut monetar, të kapitalit dhe të këmbimit valutor.

Sipas Rregullorës, Bordi Drejtues është i përberë prej shtatë anëtarëve, të integritetit të njohur dhe me eksperiencë profesionale në çështjet financiare dhe bankare, të emëruar nga Përfaqesuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm: Kryetari i Bordit, Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Mbikëqyrje dhe Rregullim të Institucioneve Financiare, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Sistemet e Pagesave, dhe tre persona të tjerë (dy prej të cilëve duhet të jenë të zgjedhur prej Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë).

Bordi Drejtues ka këto kompetenca:

- të përcaktojë politikat për zbatimin e kompetencave të BPK-së dhe të mbikëqyrë implementimin e tyre nga menaxhmenti dhe stafi punues;
- të miratojë të gjitha rregullat, urdhërat dhe direktivat e lëshuara nga BPK-ja;

- të aprovojë të gjitha raportet dhe rekomandimet që BPK-ja I bën Administratës së Përkohshme të KB-së në Kosovë;
- të bëjë rekomandime të Perfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për participimin e BPK-së në konsultimet teknike me organizatat ndërkombetare;
- të miratojë statutin e BPK-së;
- të përcaktojë organizimin e BPK-së;
- të aprovojë caktimin e Inspektorit të Përgjithshëm të BPK-së;
- të themelojë dhe sipas nevojave të mbyllë zyrat e degëve dhe agjencitë e BPK-së;
- të përcaktojë buxhetin e BPK-së si dhe afatet dhe kushtet e punësimit të punëtorëve, agjentëve dhe korrespondentëve të BPK-së;
- të përcaktojë politikat e kontabilitetit të BPK-së dhe të aprovojë raportet periodike dhe gjendjet financiare të BPK-së;
- të vendos për borxhin e shkaktuar në shuma materiale nga BPK-ja dhe për afatet dhe kushtet e borxhit të tillë;
- të përcaktojë kategoritë e mjeteve që do të jenë të përshtatshme për investimin e resurseve financiare të BPK-së;
- të aprovojë ose refuzoj aplikacionet për licencë ose regjistrim të institucionit financiar dhe të revokojë licencën ose regjistrimin e institucionit financiar; dhe
- të përcaktojë strukturat interne, politikat dhe procedurat për licensim, regjistrim, mbikëqyrje dhe rregullim të institucioneve financiare.

Drejtori i Përgjithshëm i BPK-së shërben si shef ekzekutiv i BPK-së dhe përgjigjet për veprimtarinë e përditshme të BPK-së. Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Mbikëqyrje të Institucioneve Financiare dhe Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Sistemet e Pagesave janë përgjegjës ndaj Drejtorit të Përgjithshëm. Gjatë mungesës së Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendës Drejtori I Përgjithshëm për Mbikëqyrje të Institucioneve Financiare, ose në mungesë së tij, Zëvendës Drejtori I Përgjithshëm për Sisteme të Pagesave, vepron si shef ekzekutiv I BPK-së. Drejtori I Përgjithshëm është përgjegjës ndaj Bordit Drejtues për ekzekutimin e vendimeve të Bordit dhe për drejtimin dhe kontrollin e administrimit dhe operimit të BPK-së.

Të gjitha autoritetet që nuk janë të rezervuara në mënyrë specifike për Bordin Drejtues janë në kompetenca të Drejtorit të Përgjithshëm. Brenda kufizimeve të autoritetit të tij/saj, Drejtori i Përgjithshëm ka autoritet të përdor të gjitha masat që kërkohen ose që konsiderohen se janë të përshtatshme për administrimin ose operimin e BPK-së, duke përfshirë hyrjen pa kufizime në angazhime kontraktuese në emër të BPK-së, emërimin e punëtorëve, agjentëve dhe korrespondentëve të BPK-së, dhe në përgjithësi të përfaqësojë BPK-në. Drejtori i Përgjithshëm, me aprovimin e Bordit Drejtues, mund të kalojë një pjesë të autoritetit të tij ose të saj te punëtorë të tjerë të BPK-së.

Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Mbikëqyrje të Institucioneve Financiare është përgjegjës ndaj Drejtorit të Përgjithshëm. Ai/ajo ka autoritet të përdor masa detyruese, duke përfshirë urdhërin që ndonjë institucion financiar të marr masa korrigjuese, të përcaktojë administrator të përkoheshëm për institucionin financiar, ose të ngarkojë atë me dënimet e parapara në këtë rregullore, ligje ose rregullore të tjera të zbatueshme për licencim, mbikëqyrje dhe rregullim të institucioneve financiare.

4.2. OPERACIONET E BPK-SË

Gjatë vitit 2001, BPK-ja ka operuar përmes zyrës së saj qendrore në Prishtinë dhe 22 zyrave të degëve dhe nën-degëve të hapura në mbarë Kosovën. Bërthama e operacioneve të BPK-së, sikurse është mbikëqyrja financiare dhe licensimi, është rritur dukshëm. Operacionet e llojeve komerciale, gjithashtu kanë vazhduar të sigurohen. Një funksion i tillë kryesor i kryer përmes rrjetit të degëve të BPK-së ka siguruar shërbimet e pagesave për UNMIK-un, Autoritetin Qendror Fiskal dhe entitetet tjera, përfshirë pagat dhe pagesat e ndihmës sociale. Po ashtu nga BPK-ja janë mundësuar mbledhja e tatimeve dhe pagesa të tjera, shërbimet e depozitave bankare, pagesat brenda vendit dhe ato ndërkombëtare.

RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E SEKTORIT FINANCIAR

Sipas Rregullorës 2001/24 të UNMIK-ut, e cila e plotësoi Rregullorën 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, BPK-ja është përgjegjëse për licensimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare në Kosovë. Përgjegjësia për implementimin dhe zbatimin e funksioneve mbikëqyrëse të BPK-së bie mbi tre departamente:

- Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare,
- Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe
- Departamenti i Mbikëqyrjes së Pensioneve.

4.2.1 MBIKËQYRJA BANKARE

Viti 2001 ka vazhduar të jetë vit i rindërtimit të sistemit bankar të Kosovës. Në vitin 1999, kur BPK-ja është themeluar, në Kosovë nuk ka pasur asnjë bankë tjetër. Rregullorja kryesore e UNMIK-ut, ajo numër 1999/21 për Licensimin e Bankave, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin Bankar, është miratuar më 15 nëntor 1999. Me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtar, në përfundim të vitit 2000 është zhvilluar korniza rregullative e shëndoshë e sektorit financiar dhe është organizuar dhe profesionalisht është aftësuar njësi e mbikëqyrjes për të ofruar mbikëqyrje efektive të sektorit financiar, përfshirë bankat dhe institucionet financiare jo-bankare.

Korniza Rregullative

Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare nxjerr autoritetin dhe përgjegjësinë e tij të licencojë dhe të mbikëqyrë bankat dhe institucionet financiare nga Rregulloret e UNMIK-ut.

Rregullorja 1999/21 veçanërisht ofron kornizën për licensimin e bankave, organizimin dhe qeverisjen e tyre, lëshimin e rregullave dhe urdhërave për shmangien nga rreziku dhe gjykimin e drejtë profesional, mirëmbajtjen e shënimeve financiare dhe llogarive në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), kërkesat për kontroll financiar të jashtëm e inspektimet e brendshme si dhe aplikimin e masave detyruese ose dënimeve për të siguruar pajtueshmëri me rregullorën.

Veç kësaj, nga fundi i vitit 2001, nga Bordi Drejtues janë miratuar njëzet e një rregulla për shmangien nga rreziku dhe gjykimin e drejtë profesional - te cilat themelojnë limite, direktiva operative, procedura, dhe kërkesa raportuese për banka dhe institucione financiare.

Aktiviteti i licensimit

Bankat komerciale

Sipas Rregullorës së UNMIK-ut, bankat janë të definuara si persona juridikë që pranojnë depozita dhe shfrytëzojnë këto fonde ose në terësi ose pjesërisht për qëllime të dhënies së kredive ose për investime me rrezik të tyre. Banka mund të marrë licensën prej BPK-së, nëse janë plotësuar kushtet në vijim:

- plani I biznesit të saj është i bazuar në analiza të shëndosha sipas supozimeve të arsyeshme,
- banka është në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e rregullimit bankar,
- kualifikimet, eksperiencia dhe integriteti I administratorëve të bankës, aksionarëve kryesor dhe atyre që synojnë të kenë ose kanë interes në këtë bankë, janë të përshtatshëm për bankën, dhe
- plotësimi i kërkesave për minimum të kapitalit.

Nga fundi i vitit 2000, vetëm një bankë ka plotësuar kërkesat për licensë të bankës. Megjithatë, kah fundi i vitit 2001, kanë qenë shtatë banka duke vepruar në Kosovë me totalin e mjeteve prej 519 milionë eurosh, totalin e kredive prej 25 milionë eurosh dhe totalin e depozitave prej 492 milionë eurosh. Në fund të vitit 2001, shtatë banka dhe 25 degë të tyre ishin duke operuar në mbarë Kosovën. Tri aplikacione të bankave janë refuzuar nga BPK-ja gjatë vitit 2001. Poashtu, aprovimi preliminar për licensë të bankës është pezulluar për katër banka.

Struktura e pronësisë së sektorit bankar më 31 dhjetor 2001, e matur me kapital aksionar, ka qenë 63% kapital i huaj dhe 37% kapital vendor. Nuk ka pronësi shtetërore të bankave në Kosovë, megjithatë, 6% e kapitalit aksionar në sistemin bankar i takon ndërmarrjeve me pronësi shoqërore.

Institucionet financiare jo-bankare

BPK-ja është përgjegjëse për licensimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare jo-bankare. Institucionet mikro financiare (IMF) ishin institucionet e para financiare zyrtare që hyrën në tregun financiar të pas-luftës, në pjesën e dytë të vitit 1999. Nga fundi i vitit 2001, BPK-ja ka regjistruar pesëmbëdhjetë institucione financiare jo-bankare që janë angazhuar në mikro financa dhe huadhënie për ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Këto institucione janë të ndihmuara prej donatorëve ndërkombëtar. Përpos individëve, ato japin kredi edhe në baza grupore, që janë të garantuara nga anëtarët individual të grupit. Institucionet financiare jo-bankare janë duke ndihmuar në krijimin e një sistemi stabil që u ofron shërbime financiare grupeve të varfëra dhe bizneseve të vogla, që nuk kanë mundësi tjetër për të hyrë në kredi. Në fund të vitit 2001, kreditë e papaguara për këtë sektor ishin 22 milionë euro.

Sipas rregullit XVI të BPK-së për Regjistrimin, Licensimin dhe Mbikëqyrjen e Zyrave për Këmbime Valutore dhe Shërbimeve të Transferimit të Parave, entitetet që operojnë si zyra për këmbime valutore ose shërbime për transfer të parave, janë të detyruara të regjistrohen në BPK dhe duhet të pajtohen me kërkesat operative të cekura në këtë rregull. Nga fundi i vitit 2001, BPK-ja ka aprovuar aplikacionet për të themeluar tri zyra për këmbime valutore, dhe dy aplikacione prej entiteteve për të udhëhequr shërbime për transfer të parave.

Tabela 11.

Struktura e sistemit financiar

| Llojet e institucioneve financiare | Numri | Numër zyrësh |
|---|-------|--------------|
| Bankat e Licensuara | 7 | 25 |
| Bankat me aprovim të licensave preeliminare | 0 | n/a |
| Institucionet mikro financiare | 15 | 29 |
| Zyrat e kembimit | 3 | 4 |
| Operatorët e transfereve elektronike | 2 | 42 |

Tabela 12.

Sistemi financiar, kreditë dhe depozitat – 31 dhjetor 2001

Mijë euro

| | Kreditë | Depozitat |
|--------------------|---------------|----------------|
| Bankat | 25.135 | 492.255 |
| IMF dhe jo-bankare | 22.359 | 38 |
| TOTALI | 47.494 | 492.293 |

Procesi mbikëqyrës**Filozofia mbikëqyrese / Strategjia**

Qëllimi i BPK-së është mbikëqyrja dhe një proces rregullues që është efektiv, fleksibil dhe që promovon një sistem konkurrues bankar. Gjatë vitit 2001, ekspertët ndërkombëtarë, të përcaktuar për BPK-në prej USAID-it dhe FMN-së, kanë vazhduar të ndihmojnë në themelimin e funksionit të mbikëqyrjes bankare, i cili është i bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe parimet kryesore për mbikëqyrje efektive bankare, të themeluara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare. Kjo ka përfshirë punësimin dhe trajnimin e stafit të ri të mbikëqyrjes bankare, zhvillimin e politikave dhe procedurave mbikëqyrese si dhe implementimin e kornizave të raporteve rregullative të bazuara në SNK. Një prej

objektivave kryesore të këshilltarëve ndërkombëtarë është që të arrihet transferimi i plotë i përgjegjësi të mbikëqyrjes në stafin lokal kosovar për mbikëqyrje bankare.

Politikat dhe procedurat mbikëqyrëse

Gjate vitit 2000, në BPK janë zhvilluar dhe implementuar dy udhëzime për politika mbikëqyrëse të bankave: Udhëzimi i licensimit të bankave dhe Udhëzimi i mbikëqyrjes bankare, të cilët cekin politikat dhe procedurat e licensimit dhe mbikëqyrjes së bankave. Gjate vitit 2001, janë bërë përmirësime të mëtejshme në politikat mbikëqyrëse, për të siguruar korniza efektive për funksionim të shëndosh të sektorit bankar.

Udhëzimet për licensimin e bankave përfshijnë format e standardizuara dhe procedurat për licensim të bankave dhe institucioneve jo-bankare. Udhëzimi i mbikëqyrjes bankare ofron procedurat e standardizuara të mbikëqyrjes së brendshme, të bazuara në sistemin pesë-shkallësh CAMEL, për të përcaktuar klasifikimet e bankave dhe për të mundësuar efikasitet më të lartë në ndërmarrjen e inspektimeve dhe ekzaminimeve. Procedurat dhe politikat e mbikëqyrjes janë të bazuara në të ashtuqujturën “mbikëqyrje sipas riskut”, të cilat i mundësojnë BPK-së të caktojë resurset e saj të mbikëqyrjes në fushat me risk më të madh brenda bankave individuale dhe sistemit bankar. Mbikëqyrja sipas riskut përqendrohet në aftësitë e menaxhmentit të identifikojë, mat, monitorojë dhe kontrollojë riskun.

Aktivitetet mbikëqyrëse monitoruese

Për të zbatuar përgjegjësitë e tij për licensim dhe mbikëqyrje të bankave dhe institucioneve financiare, Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare është duke ushtruar një qasje aktive të mbikëqyrjes së vazhdueshme përmes inspektimit të brendshëm dhe monitorimit të jashtëm.

Gjatë vitit 2001, inspektorët e BPK-së kanë udhëhequr 11 inspektime të brendshme në banka dhe 10 inspektime në institucione kreditore jo-bankare. Raportet rregulative bankare janë analizuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare në baza mujore dhe tremujore me qëllim monitorimin e pajtueshmërisë së këtyre institucioneve me kërkesat për operacionet bankare të sigurta dhe të shëndosha. Veç kësaj, gjate vitit 2001 janë procesuar nga Departamenti I Mbikëqyrjes Bankare gjashtë aplikacione për licencë të bankave

Rregullorja e UNMIK-ut përfshin dispozitat për masat detyruese ndaj të gjitha mos-pajtueshmërive me rregullorën, rregullat e BPK-së ose për praktika të pasigurta dhe të pashëndosha bankare. Sipas rregullores, masat detyruese rangohen prej vërejtjeve të shkruara deri te pezullimi i licencës. Gjatë vitit 2001, nuk është ndërmarr asnjë veprim detyrues formal kundër bankave ose institucioneve financiare.

Tabela 13.

Rregullat e BPK-së mbi gjykimin e drejtë dhe shmangien e rrezikut

| Numër | përshkrimi |
|-----------|---|
| Nr. I | për mjaftueshmërinë e kapitalit |
| Nr. II | për koncentrimet e kredive |
| Nr. III | per patundshmëri dhe kufizimet në mbajtjen e mjeteve fikse |
| Nr. IV | për mbajtjen e mjeteve likuide |
| Nr. V | per ekspozimet e mëdha |
| Nr. VI | për licensimin dhe kufizimet e filialave të bankave të huaja |
| Nr. VII | për aktivitetet e kembimeve të huaja |
| Nr. VIII | për qeverisjen e bankës |
| Nr. IX | për klasifikimet e mjeteve të bankes, rezervat dhe kamatat e pa-përlllogaritura |
| Nr. X | për pastrimin e parave |
| Nr. XI | për raportimin e bankave |
| Nr. XII | për ruajtjen e shenimeve |
| Nr. XIII | për aksionarët kryesor dhe të tjerët që e kontrollojnë bankën |
| Nr. XIV | për licensimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve mikro financiare |
| Nr. XV | per versionet e përkthyer të rregullave dhe të urdhërave |
| Nr. XVI | për licensimin dhe mbikëqyrjen e zyrave për këmbime valutore dhe shërbimeve për transfere të parave |
| Nr. XVII | për minimumin e kërkuar të rezervës së likuiditetit |
| Nr. XVIII | për kliringun dhe operacionet e llogarive për shlyerje |
| Nr. XIX | për sistemin e numrave të llogarive të bankave të Kosovës |
| Nr. XX | për kufizimet e kredive |
| Nr. XXI | për rritjen e minimumit të kapitalit të bankave |

Stafi dhe trajnimi

Qëllimi i BPK-së është të ketë staf profesional të mbikëqyrësve bankarë të trajnuar mirë, të cilët janë të informuar mirë për teknikat moderne të mbikëqyrjes bankare të bazuara në risk. Programi formal i trajnimit është zhvilluar për mbikëqyrësit bankarë. Programi i trajnimit përfshin trajnimin formal përmes seminareve dhe trajnimin në punë. Gjatë vitit 2001, gjashtë seminare trajnuese janë mbajtur nga një ekspert ndërkombëtar për trajnime të mbikëqyrjes bankare në fushat në vijim: mbikëqyrja themelore bankare; analizat e jashtme të

avancuara; etika dhe udhëheqja profesionale e mbikëqyrësve; mbikëqyrja e avancuar bankare; trajnimi i trajnerit dhe teknikat e ekzaminimit të menaxhmentit.

Përveç seminareve për mbikëqyrjen bankare, këshilltarët ndërkombëtarë i kanë ofruar stafit të mbikëqyrjes bankare trajnim të gjërë në punë përgjatë vitit 2001 gjatë inspektimeve të brendshme dhe aktiviteteve të monitorimit të jashtëm.

4.2.2 MBIKËQYRJA E SIGURIMEVE

Gjatë vitit 1999, një sistem i licencimit të kompanive të sigurimit është futur në përdorim nga shtylla II e UNMIK-ut sipas Urdhëresës Administrative Nr. 1999/3 me të cilën pesë kompanitë e sigurimeve janë licencuar gjatë vitit 2000 që të ndërmarrin sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësive për palën e tretë, me përjashtim të sigurimit për jetë. Gjatë vitit 2001 u vendos që të përgatitet dhe të vihet në përdorim një rregullore moderne, dhe që kompanitë e sigurimeve të licencohen, rregullohen dhe mbikëqyren nga BPK-ja.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimeve dhe Ndërmjetësuesëve të Sigurimeve, e aprovuar me 5 tetor 2001, u ngrit si një regjim i ri regullativ, i bazuar në parimet e Bashkimit Evropian dhe i mbikëqyrur nga BPK-ja. Nën këtë rregullore, mbikëqyrja e pesë kompanive që ofrojnë sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësive për palën e tretë, me përjashtim të sigurimit për jetë, është bartur nga shtylla II e UNMIK-ut në BPK. Autoriteti efektiv i mbikëqyrjes dhe i licencimit, poashtu i janë bartur BPK-së. Kompanitë ekzistuese u lejuan që të veprojnë sipas licencave që janë leshuar nga shtylla II e UNMIK-ut, ndërsa kompanitë e reja që kërkojnë licencë për kompani të sigurimeve nevojitet që të aplikojnë për licencim pranë BPK-së.

Deri më 31 dhjetor 2001, Departmenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka rishikuar aplikacionet për licencim të katër kompanive ekzistuese. Bazuar në autoritetin ekzekutues të BPK-së, që rrjedh nga rregullorja e re mbi sigurimet, një administrator i përkohshëm është emëruar në vend të udhëheqësisë në njërin nga kompanitë e sigurimeve. Më pas, kjo kompani është vendosur nën administrim të detyrueshëm.

Gjendja e zhvillimit të Departmentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve

Deri në fund të vitit 2001, është krijuar një department funksional i rregullimit të sigurimeve si dhe janë themeluar programet trajnuese për kuadrin e tij. Njëmbëdhjetë inspektorë të rinj janë punësuar dhe janë duke u ushtruar rreth mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme të kompanive të sigurimeve. Inspektorët poashtu marrin trajnime gjatë orarit të punës me programe të kohëpaskohëshme trajnuese brenda BPK-së, me qëllim të zgjerimit të njohurisë dhe kuptimit të mbikëqyrjes së sigurimeve.

Pesëmbëdhjetë rregulla të gjykimit të drejtë dhe të shmangies së rrezikut janë përpiluar rreth çështjeve siç janë: klasat e përgjithshme të sigurimeve, sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjesisë për palën e tretë, licencimi i kompanive të sigurimeve, licencimi i ndërmjetësuesëve të sigurimeve, licencimi i rregulluesëve të dëmeve, licencimi i agjentëve të klasëve shtesë, kërkesat financiare të ndërmjetësuesëve të sigurimeve, standardet e kontabilitetit dhe nevoja e mbajtjes së shënimeve, kapitali minimal i nevojshëm dhe margjina e aftësisë paguese, rezervat e nevojshme të kompanive të sigurimeve të përgjithshme dhe kompanive të sigurimeve jetësore dhe vlerësimi i mjeteve.

4.2.3 MBIKËQYRJA E PENSIONEVE

Nën Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë e miratuar më 22 dhjetor 2001, BPK-ja mban mbikëqyrjen rregullative të planeve pensionale shtesë (planet e punëdhënësëve dhe planet individuale të pensioneve) të aplikuara në Kosovë. Në fund të vitit 2001, BPK-ja gjendej në proces e sipër të themelimit të Departmentit të Mbikëqyrjes së Pensioneve me qëllim të marrjes së përgjegjesisë rreth rregullimit të planeve pensionale siç kërkohet me rregullore.

4.3 SISTEMI I KLIRINGUT NDËRBANKAR

Sistemi i kliringut ndërbankar (SNP) është themeluar në maj të vitit 2001 në mënyrë që të lehtësoj veprimet me pagesa vendore dhe t'i kanalizojë ato nëpërmjet sistemit bankar. Këtë e ka mundësuar tradita ekzistuese bankare, kultura si dhe rezultati i zhvillimit të shpejtë të marrëdhënieve të mira në mes të bankave dhe klientëve të tyre. Sistemi i kliringut është dashur të zhvillohet dhe të funksionojë plotësisht nga fundi i vitit 2001. Rritja e shpejtë e veprimeve përmes SNP dëshmoi që besueshmëria e kosovarëve në sistemin vendor bankar po rritej dita ditës.

Fillimisht është zbatuar sistemi manual i kliringut, ku secila bankë komerciale ka përgatitur pagesat ndërbankare në disketa dhe sipas marrëveshjes janë shkëmbyer ato disketa në BPK. Në fund të vitit 2001, sistemi fillestar është zëvendësuar me një version elektronik të sistemit të pagesave - Sistem Elektronik i Transfereve Ndërbankare (SETN), me qëllim që të ndërlihdë të gjitha bankat komerciale participuese me anë të rrjetit telefonik (Dial-up) për transmetimin e urdhërpagesave ndërmjet bankave.

Me fillimin e punës së këtij sistemi, në mënyrë të ngjajshme ishte themeluar Komiteti Këshillues i Pagesave Ndërbankare (IPAC), që të shqyrtoj të gjitha çështjet lidhur me pagesat që nuk janë në para të gatshme në Kosovë. Komiteti Këshillues i Pagesave Ndërbankare (IPAC) kryesohet nga drejtori i Sistemit të Kliringut Ndërbankar të BPK-së ku të gjitha bankat komerciale pjesmarrëse janë anëtare.

Në bashkëpunim të afërt me IPAC ishte e mundur që të zhvillohen të gjitha procedurat operative ditore të SNP-së dhe të shqyrtohen shumë çështje tjera si p.sh. format standarde të SNP, strukturat e tarifave të SNP, rregullat operative të SNP, përshtatja e sistemit të numrave standardë të llogarive bankare të bazuara në IBAN, si dhe format e zakonshme të urdhër-transfereve për pagesa ndërbankare dhe dypalëshe.

Ekipi punues teknik i IPAC-ut u themelua me pjesëmarrjen e ekspertëve të teknologjisë informative nga të gjitha bankat për lehtësim të implementimit të mëtejshëm të Sistemit Elektronik të Transferit Ndërbankar.

Vëllimi i veprimeve me pagesa ndërbankare

Në fushën e vëllimit të operativës së SNP, si për nga numri ashtu dhe vlera totale e transaksioneve, vërehet që ka një rritje të qëndrueshme. Në fund të vitit mesatarja ditore e numrit të transaksioneve ka arritur pesëdhjetëshin dhe të gjitha urdhërpagesat u kryen në mënyrë efektive dhe me kohë. Gjatë kësaj periudhe, përmes zyrës së kliringut, u realizuan pagesa masive të pagave për entitete të ndryshme.


Procesi i konvertimit në euro dikoi mjaft në numër të veprimeve të SNP, veçanërisht gjatë muajit dhjetor të vitit 2001. Vëllimi i rritjes së shpejtë të veprimeve të SNP ka shprehur dhe nevojën për automatizim dhe modernizim të mëtijshëm të Departamentit të Sistemit të Kliringut Ndërbankar.

Tabela 13.

| Veprimet me pagesa ndërbankare nga muaji maj I vitit 2001 | | | | '000 DEM |
|---|----------------|---------------------|--------------------------------|----------------------|
| Periudha | Nr. i pagesave | Shuam totale e pag. | Mesatarja ditore e nr. të pag. | Shuma mesatare e pag |
| Maj | 204 | 12.269 | 10.20 | 60 |
| Qershor | 403 | 11.724 | 20.15 | 29 |
| Korrik | 492 | 18.666 | 24.60 | 38 |
| Gusht | 556 | 13.212 | 27.80 | 24 |
| Shtator | 651 | 16.370 | 32.55 | 25 |
| Tetor | 890 | 13.999 | 44.50 | 16 |
| Nëntor | 825 | 31.114 | 41.25 | 38 |
| Dhjetor | 1.103 | 51.310 | 55.15 | 47 |
| TOTAL | 5.124 | 168.664 | 32.03 | 35 |

Figure 1.

Veprimet me pagesa ndërbankare në muajin maj të vitit 2001



4.4 MENAXHIMI I ASETEVE (MJETEVE FINACIARE) TË JASHTME

Funksioni i BPK-së i menaxhimit të aseteve (mjeteve financiare) të jashtme u zhvillua dukshëm dhe në përputhje me rritjen e qëndrueshme të depozitave të klientëve gjatë vitit 2001. Roli i Komitetit të Investimeve, i cili mbikëqyrte dhe kontrollonte operacionet e menaxhimit të aseteve të jashtme, gjithashtu ndryshoi duke marrë vetëm formën e mbikëqyrjes. Në operacionet e hershme të BPK-së ekzistonte një lidhje e fortë midis investimeve, kërkesave për para të gatshme dhe likuiditetit që ishte i nevojshëm për pagesat e jashtme. Gjatë vitit 2001, paraja e gatshme në qarkullim arriti sasinë optimale dhe rrjedhimisht fondet e depozituara në BPK u bënë të gatshme për investime.

Në periudhën deri te euro konvertimi, BPK-ja zhvilloi marrëdhënie më të afërta me bankat e tjera qendrore të Europës dhe e avancoi njohjen e saj. Ajo gjithashtu vazhdoi marrëdhëniet e saja të mira të punës me bankat korrespondente në Gjermani dhe Austri. Përderisa respektonte rregullat e përgjithshme të shmangies nga risqet, mbante likuiditetin dhe sigurinë adekuate të investimeve të saja, BPK-ja gjithashtu ishte në gjendje të përmirësojë kthimin nga investimet e saja.

Menaxhimi i aseteve të jashtme i kontribuoi procesit të euro konvertimit duke siguruar sjelljen e suksesshme të kartëmonedhave dhe monedhave të eurosë në dhjetor dhe duke planifikuar në mënyrë të suksesshme disponueshmërinë e fondeve për eksport/import të valutave. Gjatë dhjetorit afro 200 milionë DEM u konvertuan në euro për të mundësuar sjelljen e valutës së re.

Gjatë vitit 2001, stafi i menaxhimit të aseteve të jashtme gradualisht përmirësoi ekspertizën e tij teknike dhe kreu funksionet përgatitore dhe kontribuoi në proceset e marrjes së vendimeve investive. Ndarja e detyrave midis aktiviteteve afariste dhe përlllogaritare vazhdoi të respektohej në mënyrë strikte. Menaxhimi i aseteve të jashtme ishte në një anë i mbikëqyrur nga Komiteti i Investimeve dhe nga ana tjetër i verifikuar dhe kontrolluar përmes procedurave të brendshme të Zyrës për mbështetje dhe administrim në kuadër të Departamentit të Kontabilitetit.

Funksionet e Zyrës për mbështetje dhe administrim përkrahin operacionet e Zyrës për tregtime dhe marrëdhëniet afariste me jashtë, duke siguruar informata aktuale mbi saldot e të gjitha nostro llogarive (llogaritë e BPK-së në banka të huaja), përputhshmërinë e procesit të lëvizjes së parave të gatshme dhe regjistrimin e përpiktë të të gjitha transaksioneve.

Rritja e sektorit të bankave komerciale ka zvogëluar trynitë mbi BPK, meqë aktivitetet e tipit komercial kanë kaluar në bankat komerciale. Aktivitet e pagesave të jashtme ende vazhdojnë të kryhen nga BPK-ja, por numri i pagesave dhe shumat tani janë dukshëm më të vogla.

4.6. BANKAT E LICENSUARA

Banka Amerikane e Kosoves

1 Luan Haradinaj
Prishtine, Kosove
+381 038 226 400

Banka Private e Buznesit

Rruga Vellusha 6
Prishtine, Kosove
+381 038 548 901

Banka Ekonomike

5a Qafa
Prishtine, Kosove
+381 038 228 693

Banka Kreditore

29, Tirana
Prishtine, Kosove
+381 038 549 851

KASA Banka

1, Rr. Pal Palucaj
Prishtine, Kosove
+381 038 500 597

Micro Enterprise Bank

Rr. Skenderbeu
Prishtine, Kosove
+381 038 248 778

Banka e Re e Kosoves

54, Rr. Nena Tereze
Prishtine, Kosove
+381 038 517 130

4.5. REZULTATET E AUDITUARA 2001

REZULTATET E AUDITUARA 2001

*Autoriteti Bankar
dhe i Pagesave te Kosoves*

*Raporti i auditorëve të pavarur dhe
pasqyrat financiare për vitin 2001*

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
TABELA PERMBLEDHESE

| | PAGE |
|---|---------------|
| DEKLARATA E PERGJEGJESIVE TE DREJTIMIT | 1 |
| RAPORTI I AUDITOREVE TE PAVARUR | 2 |
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| BILANCI | 3 |
| PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE | 4 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT DHE REZERVAVE | 5 |
| PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE | 6 |
| SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE | 7 - 18 |

**PERGJEGJESIA E DREJTIMIT PER PASQYRAT FINANCIARE TE AUTORITETIT BANKAR
DHE PAGESAVE TE KOSOVES**

Pasqyrat financiare shoqeruese te Autoritetit Bankar dhe Pagesave te Kosoves ne faqet 3 deri 18 jane pergjegjesia dhe te aprovuara nga Drejtuesit.

Pasqyrat financiare jane pergatitur nga drejtimi ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit. Pasqyrat financiare perfshijne disa shuma qe jane bazuar ne vleresimet dhe gjykimet me te mira sipas dates se raportit.

Ne opinionin tone informacioni i paraqitur ne Bilancin, Pasqyren e te Ardhurave, Pasqyren e Ndryshimit te Kapitalit dhe Rezervave dhe Pasqyren e Rrjedhes se Parase bashkangjitur se bashku me informacionin ne shenimet shoqeruese, paraqet ne menyre te drejte pozicionin financiar, rezultatin financiar, ndryshimet ne kapital dhe rezerva dhe rrjedhjes se parase per periudhen deri me 31 Dhjetor 2001 dhe per periudhen nga 15 Nentor 1999 deri 31 Dhjetor 2000.

Auditoret e pavarur te Deloitte & Touche, kane qene te angazhuar ne auditimin e ketyre pasqyrave financiare dhe raporti i tyre eshte i perfshire ne faqen 2.

Chaiha Kim Rhee
Drejtori Menaxhues

Benoit Waelkens
Zëvendës Drejtor Menaxhues

Date

RAPORTI I AUDITOREVE TE PAVARUR

Bordit Drejtues te Autoritetit Bankar dhe Pagesave te Kosoves:

Ne kemi audituar bilancin e Autoritetit Bankar dhe Pagesave te Kosoves (BPK ose Banka) me 31 Dhjetor 2001 dhe 2000, si dhe pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyren e ndryshimeve te kapitalit te vet dhe pasqyren e rrjedhjes se parase per fundviten 31 Dhjetor 2001 dhe per periudhen nga 15 Nentor 1999 deri me 31 Dhjetor 2000. Drejtimi Bankes eshte pergjegjes per pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare. Pergjegjësia jone eshte te japim opinion mbi keto pasqyra bazuar ne auditimin tone.

Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te planifikojme dhe te zbatojme procedurat e auditimit per te dhene nje siguri te arsyeshme nese pasqyrat financiare jane pa gabime materiale. Nje auditim perfshin ekzaminimin, ne baze testimesh, te dokumentave qe mbeshketin shifrat dhe informacionet e tjera te pasqyrave financiare. Auditimi gjithashtu perfshin vleresimin e parimeve kontabel te perdorura dhe parashkimeve kryesore te bera nga Drejtimi, si dhe jep nje opinion te pergjithshem mbi paraqitjen e pasqyrave fianciare. Ne besojme se auditimi yne ofron baza te arsyeshme per dhenien e opinionit.

Sipas opinionit tone pasqyrat financiare paraqesin ne menyre te drejte, ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te Bankes me 31 Dhjetor 2001 dhe 2000 dhe rezultatet e aktiviteve te saj, ndryshimeve ne kapitalin e vet dhe rrjedhjes se parase per fundviten me 31 Dhjetor 2001 dhe per periudhen nga 15 Nentor 1999 deri 31 Dhjetor 2000 ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit ("SNK).

Deloitte & Touche,
Tirana

4 Tetor 2002

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
BILANCI
ME 31 DHJETOR 2001

| | Shenim No | 2001 DEM'000 | 2000 DEM'000 |
|--|--------------|------------------------------|------------------------------|
| Aktivet | | | |
| Aktive te huaja | | | |
| Llogari rrjedhese ne banka te huaja | 3 | 194,368 | 1,024 |
| Depozita ne banka te huaja | 4 | <u>90,000</u> | <u>89,000</u> |
| Totali i aktiveve te huaja | | <u>284,368</u> | <u>90,024</u> |
| Aktive vendase | | | |
| Para ne arke | | 383,600 | 29,870 |
| Aktive te tjera vendase | 5 | <u>2,761</u> | <u>1,778</u> |
| Totali i aktiveve vendase | | <u>386,361</u> | <u>31,648</u> |
| Totali i aktiveve | | <u><u>670,729</u></u> | <u><u>121,672</u></u> |
| DETYRIME | | | |
| Detyrime vendase | | | |
| Detyrimve ndaj bankave vendese | 6 | 428,704 | 32,356 |
| Detyrime ndaj institucioneve qeveritare | 7 | 155,728 | 44,084 |
| Detyrime ndaj institucioneve tregtare dhe publike | 8 | 28,329 | 33,888 |
| Detyrime te tjera vendase | 9 | <u>45,257</u> | <u>3,262</u> |
| Totali i detyrimeve vendase | | <u>658,018</u> | <u>113,590</u> |
| KAPITALI DHE REZERVAT | | | |
| Kapitali | 10 | 5,000 | 5,000 |
| Rezervat e pergjithshme | 11 | 7,711 | 605 |
| Fitimi i pashperndare | | <u>-</u> | <u>2,477</u> |
| Totali i kapitalit dhe rezervave | | <u>12,711</u> | <u>8,082</u> |
| Totali i detyrimeve kapitalit dhe rezervave | | <u><u>670,729</u></u> | <u><u>121,672</u></u> |

Autorizuar per leshim nga manaxhimi me

Chaiha Kim Rhee
Drejtor Menaxhues

Benoit Waelkens
Zëvendës Drejtor Menaxhues

Shenimet e shoqeruara jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
BILANCI
ME 31 DHJETOR 2001

| | Shenime No | Per periudhen deri me 31Dhjetor 2001 DEM '000 | 15 Nentor 1999 deri 31Dhjetor 2000 DEM '000 |
|--|---------------|---|---|
| Veprime me jo-rezidente | | | |
| Te ardhura nga interesat | | 5,532 | 1,738 |
| Shpenzime interesi dhe komisioni | | (384) | (241) |
| Totali neto i interesave dhe komisioneve nga veprimet me jo-rezidente | | 5,148 | 1,497 |
| Veprime me rezidente | | | |
| Te ardhura nga interesa dhe komisione | | 6,634 | 1,826 |
| Shpenzime interesi dhe komisioni | | (470) | - |
| Totali neto i interesave dhe komisioneve nga veprime me rezidente | | 6,164 | 1,826 |
| Te ardhura nga grantet | 9 | 1,106 | 3,842 |
| Te tjera te ardhura operative | 12 | 244 | 162 |
| Totali neto i te ardhurat operative | | 12,662 | 7,327 |
| Te tjera shpenzime jo-operative | | | |
| Shpenzime personeli | 13 | 1,596 | 1,447 |
| Shpenzime amortizimi | 5 | 419 | 229 |
| Shpenzime te pergjithshme dhe administrative | 14 | 5,968 | 2,449 |
| Shpenzime te tjera | | 50 | 120 |
| Totali i shpenzimeve te tjera jo-operative | | 8,033 | 4,245 |
| FITIMI NETO PER PERIUDHEN | | 4,629 | 3,082 |

Shenimet e shoqeruara jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIUDHEN DERI 31 DHJETOR 2001

| | <u>Kapitali DEM'000</u> | <u>Rezerva e Pergjithshme DEM'000</u> | <u>Fitimi i Mbajtur DEM'000</u> | <u>Totali DEM'000</u> |
|--|-----------------------------|---|---|---------------------------|
| Kapitali i kontribuar per periudhen | 5,000 | - | - | 5,000 |
| Fitimi neto per periudhen | - | - | 3,082 | 3,082 |
| Transferime ne rezerven e pergjithshme | - | 605 | (605) | - |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2000 | 5,000 | 605 | 2,477 | 8,082 |
| Fitimi neto per periudhen | - | - | 4,629 | 4,629 |
| Transferime ne rezerven e pergjithshme | - | 7,106 | (7,106) | - |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2001 | <u>5,000</u> | <u>7,711</u> | <u>-</u> | <u>12,711</u> |

Shenimet e shoqeruara jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE
PER PERIUDHEN DERI ME 31 DHJETOR 2001

| | 31 Dhjetor, 2001 DEM'000 | 15 Nentor, 1999 deri me 31 Dhjetor 2000 DEM'000 |
|--|---|--|
| Rrjedha e parase nga operacionet | | |
| Fitimi neto per periudhen | 4,629 | 3,082 |
| Zera jomonetare ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve | | |
| Amortizimi | 419 | 229 |
| Te ardhura nga interesi | (12,166) | (3,564) |
| Te ardhura nga grantet | (1,106) | (3,842) |
| Ndryshimi ne aktivet operacionale | | |
| Rritja i aktiveve te tjera vendase | (527) | (796) |
| Ndryshimi ne detyrimet operacionale | | |
| Rritja e detyrimeve ndaj bankave vendase | 396,348 | 32,356 |
| Rritja detyrimeve ndaj institucioneve Qeveritare (Ulja)/Rritja ne e detyrime ndaj institucioneve tregtare dhe publike | 111,644 | 44,084 |
| Rritje ne te tjera detyrime te vendit | (5,559) | 33,888 |
| | 41,570 | 2,024 |
| Para neto nga aktivitetet operative | 535,252 | 107,461 |
| Para neto nga aktivitetet investuese | | |
| Blerje e aktiveve fikse te trupezuara | (875) | (1,211) |
| Te ardhura nga interesat | 12,166 | 3,564 |
| Para neto nga aktivitetet investuese | 11,291 | 2,353 |
| Rrjedhja nga financimet | | |
| Kapitali i derdhur | - | 5,000 |
| Fonde te marra nga grantet | 1,531 | 5,080 |
| Para neto nga financimet | 1,531 | 10,080 |
| Rritja e parase gjate vitit | 548,074 | 119,894 |
| Para ja dhe ekuivalentet e saj ne fillim te vitit | 119,894 | - |
| Para ja dhe ekuivalentet e saj ne fund te vitit | 667,968 | 119,894 |

Shenimet e shoqeruara jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIUDHEN DERI 31 DHJETOR 2001

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Autoriteti Bankar dhe Pagesave te Kosoves (Banka ose 'BPK') eshte nje insitucion i vecante publik me te drejten per te licencuar, mbikeqyrur dhe rregulluar institucionet financiare ne territorin e Kosoves. Banka u krijua ne perputhje me dispozitat e rregullores se Misionit te Brendshem Administrativ te Kombeve te Bashkuara. ne Kosove ('UNMIK') no. 1999/20 leshuar me 15 Nentor 1999 (ndryshuar me 1 Tetor 2001) 'Mbi Autoritetin Bankar dhe Pagesave te Kosoves'. Sipas kesaj rregullore objektivat kryesore te Bankes jane:

- Te promovoje per nje sistem eficient dhe te sigurte per pagesat brenda vendit, dhe
- Te kujdeset per likuiditetin, rrjedhshmerine dhe funksionimin eficient te nje sistemi financiar te bazuar ne nje treg te qendrueshem duke perfshire mbikqyrjen e bankave, kompanive te sigurimit dhe institucioneve te tjera financiare.

Banka ka kato fuqi specifike:

- Rekomandon politikat e gjera drejtuese ndaj Perfaqesuesit Special te Sekretarit te Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara per territorin ne pergjegjesine e saj, nen drejtimin e Deputetit Perfaqesues Special per Rindertim dhe Zhvillim Ekonomik;
- Formulon dhe implementon masa per sistemin e pagesave, mbikeqyr dhe rregullon ate per transaksionet me valuta vendese dhe te huaja ne Kosove;
- Zoteron dhe operon nje ose me shume sisteme pagesash;
- Vepron si bankier ndaj Autoritetit Qendror Fiscal dhe i jep atij keshilla financiare sipas kerkeses;
- Vepron si agjent fiscal per Autoritetit Qendror Fiscal ;
- Mban depozita ne valuta te huaja te bankave, Autoritetit Qendror Fiscal dhe te enteve te tjera;
- Siguron nje furnizim te pershtatshem te banknotave dhe monedhave te vogla per pagesat me para ne dore;
- Mban nje vend te sigurte per vendosjen e valutave dhe mjeteve te tjera me vlere;
- Licenson, mbikeqyr dhe rregullon institucionet financiare;
- Mbikeqyr dhe rregullon tregtaret e kembimit te valutave, dhe
- Kryen analiza te rregullta ekonomike dhe monetare te Ekonomise se Kosoves, ben publike rezultatet dhe ne baze te tyre paraqet propozime dhe masa te Misionit te Brendshem Administrativ te Kombeve te Bashkuara ne Kosove.

BPK operon me nje zyre te vendosur ne Prishtine dhe nje rrjeti degesh te ngritura ne te gjithe territorin e Kosoves. Gjate Korrikut 2002, si nje pjese e ristrukturimit te Bankes, deget e saj u moren ne drejtim nga nje banke tregtare lokale e cila u zgjodh nepermjet tenderit.

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIUDHEN DERI 31 DHJETOR 2001

2. PERMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TE RENDESISHME KONTABEL

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit ("IAS") me perjashtim te pagave te financuara nga donatoret te cilat nuk jane regjistruar si shpenzime dhe te ardhura nga grantet ne pasqyrat financiare te BPK.

Banka mban librat dhe regjistrimet e saj ne perputhje me praktikat kontabile te pergjithshme te pranuar ne territorin e Kosove se administruar nga Kombet e Bashkuara. Kombet e bashkuara.

Parimet e rendesishme kontabile te perdorura nga Banka ne keto pasqyra financiare jane paraqitur me poshte:

Baza e pergatitjes

Pasqyrat financiare te paraqitura perfshijne llogarite e Bankes te pergatitura mbi bazen e kostos historike te kontabilitetit. Pasqyrat financiare jane paraqitur ne monedhen zyrtare te territorit te Kosoves. Marken Gjermane ("DEM") duke qene se ajo ka qene monedha zyrtare ne territorin e Kosoves deri me 31 Dhjetor 2001. Ne perputhje me rregulloren e Bashkimit Monetar European monedha Euro ("EUR") u adaptua si nje monedhe e vetme ne Kosove dhe per rrjedhoje vlerat e shprehura ne DEM u konvertuan ne EUR qe nga 1 Janari 2002 me kursin fiks te kembimit EUR 1 = DEM 1.95583. Qe nga 1 Janari 2002, regjistrimet e BPK mbahen ne EUR.

Interesat dhe komisionet

Ne keto pasqyrat financiare te ardhurat dhe shpenzimet e interesit regjistrohen mbi bazen e parimeve me te drejta te konstatuara.

Te ardhurat nga komisionet kreditohen si te ardhura ne kohen kur arketohet ndersa shpenzimet nga intereset debitohet ne kohen kur paguhet.

Konvertimi ne monedhe te huaj

Transaksionet e shprehura ne monedha te huaja jane konvertuar ne DEM me kursin zyrtar te kembimit te Bankes ne daten e ndodhjes se transaksionit.

Aktivet monetare ne valute te huaj dhe detyrimet jane rikonvertuar ne DEM me kursin zyrtar te kembimit te Bankes ne ditën e fundit te periudhes kontabile dhe jane paraqitur ne pasqyrat financiare. Fitimet/humbjet e nga kurset e kembimit te perealizuara jane kredituar ngarkuar pasqyres se rezultatit.

Kursi zyrtar i kembimit i aplikuar nga banka (DEM ndaj monedhave te huaja) per monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2001 ishte si me poshte:

| | 2001 | 2000 |
|---------------------------|-------------|-------------|
| Dollari Amerikan ("USD") | 2.165 | 2.073 |
| Lira Italiane ("ITL") | 0.001 | 0.001 |
| Monedha Europiane ("EUR") | 1.955 | 1.955 |
| Franga Franceze ("FFR") | 0.298 | 0.298 |
| Franga Zvicerane ("SFR") | 1.293 | 1.269 |

2. PERMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne para ne dore, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne bankat jo vendase.

Llogarite e depozitave me bankat e huaja

Depozitat jane paraqitur ne bilanc me shumen e principalit te papaguar. Interesi eshte akumuluar ne baze te kohes dhe interesi i marre ne fund te periudhes eshte reflektuar ne aktivet e tjera.

Aktive fikse

Aktivitet fikse jane shprehur me koston historike minus amortizimin e akumuluar.

Nese vlera e tregut te nje prej aktiveve fikse eshte me e ulet se vlera e tij e mbartur per shkak te rrethanave qe nuk konsiderohen te jene te perkoheshme, ky aktiv eshte regjistruar me vleren e tij te tregut.

Fitimet dhe humbjet nga dalja jashte perdorimit te aktiveve fikse, impianteve dhe pajisjeve jane paraqitur ne pasqyren e rezultatit te vitin e daljes nga perdorimi.

Amortizimi per aktivet fikse eshte llogaritur ne baze te koston historike. vjetore Amortizimi vjetor eshte llogaritur duke perdorur metoden lineare dhe norma specifike per secilin aktiv te amortizueshem. bazuar ne kohet e vleresuar te perdorimit. Kohet e vleresuara te perdorimit gjate periudhes vjetore deri me 31 Dhjetor 2001 dhe 31 Dhjetor 2000 jane:

| | Norma vjetore e amortizimit | Koha e dobishme per pune |
|-------------------------------------|--|-------------------------------------|
| Mjete transporti | 20 % | 5 vite |
| Ndertesa, pajisje zyre dhe te tjera | 20 % | 5 vite |
| Pajisje kompjuterike | 33.3 % | 3 vite |

Te ardhura nga grantet

Grantet e marra per qellime te blerjes se aktiveve fikse, impianteve dhe pajisjeve ose aktive fikse, impiante dhe pajisje te dhuruara, jane regjistruar ne bilanc si te ardhura te ardhshme nga grantet dhe jane caktuar si te ardhura nga grantet ne te njejten periudhe te kohes se perdorimit te aktiveve fikse, ndertesa dhe pajisjeve. Grantet e marra per shpenzimet e Bankes jane kredituar direkt tek te ardhurat nga ne pasqyren e rezultatit ne periudhen kur shpenzimet ndodhin.

Vlera e tregut e instrumentave financiare

Vlera e mbartur e instrumentave financiare duke perfshire para ne dore ,llogarite rrjedhese dhe depozitat dhe detyrimet e tjera I afrohet vleres se tregut per shkak te periudhes se shkurter te maturimit te tyre.

Taksat dhe shperndarja e fitimit

Banka eshte e perjashtuar nga tatimi mbi fitimin ne perputhje me rregulloren e UNMIK-ut 1999/20 te leshuar me 15 Nentor 1999 (ndryshuar ne 1 Tetor 2001) dhe paguan me ligj cdo teprice te te ardhures neto direkt tek Autoriteti Qendror Fiskal (CFA) pas shperndarjes per te permbushur nivelet e fondeve te rezervave sipas kerkesave te Bordit Drejtues.

2. PERMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)

Rezerva e pergjithshme

Ne perputhje me rregulloren e UMNIK-ut 1999/20, cdo vit Banka do te shperndaje te ardhuren neto ne llogarine e rezerves se pergjithshme derisa llogaria e kapitalit dhe rezerves se pergjithshme te arrije 5% te shumes se pergjithshme te teprices kreditore te shumes se te gjithe llogarive te mbajtura ne librat e Bankes te paraqitur bilancin e bankes per fundin e cdo viti financiar.

Perdorimi i vleresimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit per te bere vleresime dhe parashikime qe ndikojne shumet e raportuara te aktiveve dhe detyrimeve dhe publikimin e aktiveve dhe detyrimeve ne daten e pasqyrave financiare dhe shumave te raportuara te te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIUDHEN DERI 31 DHJETOR 2001

3. LLOGARITE RRJEDHESE ME BANKAT E HUAJA

| | 2001 DEM'000 | 2000 DEM'000 |
|--------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Deutsche Bundesbank | 193,329 | - |
| Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG | 526 | 577 |
| Commerzbank AG | 481 | 434 |
| Den Norske Bank | 10 | 13 |
| Dresdner Bank | 22 | - |
| | <hr/> | <hr/> |
| Totali | <u>194,368</u> | <u>1,024</u> |

Llogarite rrjedhese te mbajtura me bankat e huaja jane te shprehura ne pergjithesi ne DEM dhe EURO. Llogarite rrjedhese me 31 Dhjetor 2001 te mbajtura ne Commerzbank AG kane norme interesi 2.5 % (31 Dhjetor 2000: 2.5 %), tek Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG kane interes 2.35 % (31 Dhjetor 2000: 3.97 %) dhe tek Deutsche Bundesbank kane interes 2.25 % (31 Dhjetor 2000: ne kete date nuk kishte balance).

Per shkak te konvertimit ne EURO, BPK-ja siguroi nje kolateral prej 193,329 mije DEM (qe ishte llogaria bankare ne Deutsche Bundesbank) si garanci per shumen ekuivalente te EUR 98,848 mije si pjese e ngarkeses se kartmonedhave dhe monedhave EURO te shperndara nga Deutsche Bundesbank me 8 Dhjetor 2001 dhe 20 Dhjetor 2001. Shuma e garantuar skadoi me 2 Janar 2002 kur banknotat dhe monedhat EURO u bene monedhe legale.

4. DEPOZITAT ME BANKAT E HUAJA

| | 2001 DEM'000 | 2000 DEM'000 |
|--------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Commerzbank AG | 4,000 | 60,500 |
| Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG | 84,000 | 28,500 |
| Dresdner Bank | 2,000 | - |
| | <hr/> | <hr/> |
| Total | <u>90,000</u> | <u>89,000</u> |

Depozitat ne bankat e huaja me 31 Dhjetor 2001 kane norme interesi qe varion nga 3.15 % deri 3.30 % (31 Dhjetor 2000: 4.68 % deri 5 %). Te gjitha depozitat e mesiperme u maturuan me 21 Janar 2002.

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIUDHEN DERI 31 DHJETOR 2001

5. AKTIVE TE TJERA VENDASE

| | 2001 | 2000 |
|---|----------------|----------------|
| | DEM'000 | DEM'000 |
| Aktivet fikse (shih me poshte) | 1,438 | 982 |
| Te arketueshme nga CFA | 596 | - |
| Interes i akumuluar | 365 | 111 |
| Te arketueshme nga gabimi i pagimit dy here | 130 | - |
| Shpenzime te parapaguara ne EURO | 120 | - |
| Te arketueshme nga Agjensia Europiane per Rindertim (EAR) | 37 | - |
| Shpenzime te parapaguara | 43 | 26 |
| Inventar i imet | 29 | - |
| Detyrime nga CFA per grante te aprovuara por te papaguara | 3 | 659 |
| Totali | 2,761 | 1,778 |

Vlera neto e regjistrimit per aktivet fikse sipas kategorive eshte si me poshte:

| | Ndertesa dhe pajisje | Pajisje zyre | Pajisje kompjuteri | Mjete transporti | Totali i ativeve fikse |
|--|---------------------------------|-------------------------|-------------------------------|-----------------------------|---------------------------------------|
| <u>KOSTO</u> | | | | | |
| Gjendja me 1 Janar 2001 | 414 | 20 | 768 | 9 | 1,211 |
| Shtesat | 330 | 92 | 376 | 77 | 875 |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2001 | 744 | 112 | 1,144 | 86 | 2,086 |
| <u>AMORTIZIMI I AKUMULUAR</u> | | | | | |
| Gjendja me 1 Janar 2001 | 10 | 17 | 201 | 1 | 229 |
| Amortizimi i vitit | 66 | 32 | 314 | 7 | 419 |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2001 | 76 | 49 | 515 | 8 | 648 |
| <u>VLERA NETO KONTABEL</u> | | | | | |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2001 | 668 | 63 | 629 | 78 | 1,438 |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2000 | 404 | 3 | 567 | 8 | 982 |

Aktivet fikse me 31 Dhjetor 2001 perfshijne DEM 478,128 (31 Dhjetor 2000: DEM 903,108) te aktiveve fikse te blera me fondet e granteve nga CFA, USAID, Agjensise Europiane per Rindertim, Bashkimi European dhe Qeveria Norvegjeze.

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIUDHEN DERI 31 DHJETOR 2001

6. DETYRIME NDAJ BANKAVE VENDASE

| | 2001 | 2000 |
|--|----------------|----------------|
| | DEM'000 | DEM'000 |
| Micro Enterprise Bank | 18,596 | - |
| Banka e Re e Kosoves | 1,413 | - |
| Banka Private e Biznesit | 828 | - |
| Banka Ekonomike e Kosoves | 173 | - |
| | <hr/> | <hr/> |
| Totali i kerkuar si rezerve likuide | 21,010 | - |
| | <hr/> | <hr/> |
| Micro Enterprise Bank | 269,765 | 24,638 |
| Banka e Re e Kosoves | 65,707 | 2,984 |
| Banka Private e Biznesit | 29,800 | - |
| Banka Amerikane e Kosoves | 19,740 | - |
| Banka Ekonomike e Kosoves | 13,597 | 1,895 |
| Banka Kredise se Kosoves | 7,914 | 2,839 |
| Kasabank sh.a | 1,171 | - |
| | <hr/> | <hr/> |
| Totali i llogarive rrjedheseve | 407,694 | 32,356 |
| | <hr/> | <hr/> |
| Total | 428,704 | 32,356 |
| | <hr/> | <hr/> |

Sipas rregullores XVII te BPK per mbikeqyrjen, bankat tregtare qe operojne ne Kosove duhet te mbajne rezerva te likuiditetit ne the BPK ne masen 5 % te depozitave totale te klienteve. Disa prej bankave tregtare me 31 Dhjetor 2001 nuk iu kerkua te mbanin rezerva te tilla meqenese aktiviteti i depozitave ne kete date ishte ende i kufizuar.

Depozitat e llogarive rrjedhese jane te ripagueshme me kerkese dhe nuk bartin interes. Rezerva e kerkuar bart interes ne normen 1.55 % me 31Dhjetor 2001 (31 Dhjetor 2000: pa interes).

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIU DHEN DERI 31 DHJETOR 2001

7. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE QEVERTARE

| | 2001 | 2000 |
|---|-----------------------|----------------------|
| | DEM'000 | DEM'000 |
| UNMIK | 5,004 | 18,425 |
| Thesari I AQF, kliente dhe taksa | 136,001 | 11,849 |
| Ente te sherbimeve publike te UNMIK | 9,925 | 10,711 |
| Detyri, me ndaj Komunave | 4,633 | 2,984 |
| Detyrime ndaj institucioneve qeveritare | 165 | - |
| Depozita ne monedha te huaja te UNMIK | - | 115 |
| Totali | <u>155,728</u> | <u>44,084</u> |

Depozitat e llogarive rrjedhese jane te ripagueshme me kerkese dhe pa interes.

8. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE TREGTARE DHE PUBLIKE

| | 2001 | 2000 |
|---|----------------------|----------------------|
| | DEM'000 | DEM'000 |
| Korparata Energjitike e Kosoves (KEK) | 1,155 | 13,383 |
| Ndermarrja e Postes dhe Telekomunikacionit te Kosoves (PTK) | 2,454 | 11,289 |
| Kompania e Sigurimit Kosova | 10,326 | 3,243 |
| Kompania e Sigurimit Siguria | 2,697 | - |
| INSIG | 3,500 | - |
| Kompania e Sigurimit Dardania | 3,929 | - |
| Institucionet financiare jo bankare | 1,027 | - |
| Entet tregtare (agjensite ndihmese dhe NGO) | 3,241 | 3,416 |
| Institucione tregtare | - | 2,557 |
| Totali | <u>28,329</u> | <u>33,888</u> |

Llogarite e mesiperme jane llogari rrjedhese te cilat jane te ripagueshme me kerkese dhe pa interes pervec kompanive te sigurimit te cilat duhet te mbajne depozita me BPK. Keto depozita te kerkuara fitojne interes vjetor duke filluar nga Gushti 2001 qe varion nga 2.2 % deri 1.66 % me 31 Dhjetor 2001.

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIUDHEN DERI 31 DHJETOR 2001

9. TE TJERA DETYRIME VENDASE

| | 2001 | 2000 |
|--|-----------------|----------------|
| | DEM '000 | DEM'000 |
| Kreditore te tjere dhe detyrime te tjera | 1,697 | 876 |
| Llogari te huaja llogari pezull (shenimi a) | 40,793 | 48 |
| Te ardhura te ardhshme nga granti (shenimi b) | 1,663 | 1,238 |
| Detyrime ndaj ish Bankes Kombetare te Kosoves (shenim c) | 872 | 872 |
| Te tjera | 232 | 228 |
| Totali | 45,257 | 3,262 |

Shenimi a: Shuma DEM 40,793 mije me 31 Dhjetor 2001 lidhet me transferimin e pagesave ne favor te klienteve te BPK te cilet jane mbyllur per llogarite e klienteve me 9 Janar 2002.

Shenimi b:

| | CFA | Grant per konvertimin e Euro CFA | USAID | Bashkimi Europian | Qeveria Norvegjeze | EAR | Total |
|--|-----------------|---|-----------------|------------------------------|-------------------------------|-----------------|-----------------|
| | DEM '000 | DEM '000 | DEM '000 | DEM '000 | DEM '000 | DEM '000 | DEM '000 |
| Fonde te Grantit te marra per periudhen | 4,054 | - | 190 | 414 | 422 | - | 5,080 |
| Transferime tek te ardhurat nga grantet | (3,488) | - | (50) | (107) | (197) | - | (3,842) |
| Te ardhurat te periudhave te ardhshme nga Granti me 31 Dhjetor 2000 | 566 | - | 140 | 307 | 225 | - | 1,238 |
| Fonde te Grantit te marra per periudhen | 412 | 738 | - | - | - | 381 | 1,531 |
| Transferime tek te ardhurat nga grantet | (328) | (337) | (63) | (121) | (98) | (159) | (1,106) |
| Te ardhurat te periudhave te ardhshme nga Granti me 31 Dhjetor 2001 | 650 | 401 | 77 | 186 | 127 | 222 | 1,663 |

CFA ka caktuar fonde ne masen DEM 2,920 mije per vitin qe mbaron me 31 Dhjetor 2001 nga te cilat DEM 737 mije u shpenzuan ne 2001 dhe shuma prej DEM 2,183 mije ne vitin 2002.

Shenim c: Shuma e detyrueshme ndaj ish Bankes Kombetare te Kosoves ka te beje me gjendjet e parave ne arke ne monedha te ndryshme qe i perkasin ketij institucioni, atyre entieteve te cilat kane qene fizikisht ne dore me fillimin e Bankes. Keto gjendje u konvertuan ne DEM ne 22 Dhjetor 2002 dhe u transferuan fizikisht ne Commerzbank AG ne Frankfurt dhe u perfshine ne llogarine rrjedhese te Bankes ne kete institucion.

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIUDHEN DERI 31 DHJETOR 2001

10. KAPITALI

Ne perputhje me rregulloren 1999/20 te UNMIK 'Mbi Autoritetin Bankar dhe Pagesave te Kosoves' kapitali i Bankes me shume DEM 5 million u kontribua nga Autoriteti Qendror Fiskal i Kosoves me 31 Mars 2000.

11. REZERVAT E PERGJITHSHME

Rezerva e pergjithshme u krijua gjate periudhes 31 Dhjetor 2000 ne perputhje me me rregulloren 1999/20 te UNMIK dhe vendim te Bordit Drejtues te Bankes. Transferta prej DEM 7,106 mije u be ne vitin 2001.

12. TE TJERA TE ARDHURA OPERACIONALE

| | 31 Dhjetor 2001 DEM'000 | 15Nentor , 1999 deri 31 Dhjetor 2000 DEM'000 |
|-----------------------------------|--|---|
| Komisione nga licencimi i Bankave | 156 | 128 |
| Te ardhura nga qiraja | 37 | 11 |
| Te tjera | 51 | 23 |
| Total | 244 | 162 |

Zeri "Te tjera" me shumen DEM 51 mije per fundvitin me 31 Dhjetor 2001 perfshin konvertimin e kartmonedhave ne Dinar te mbajtura ne nje nga deget pas luftes.

13. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzime personeli perbehen ne pergjithesi nga pagat e punonjesve. Me 31 Dhjetor 2001 Banka kishte 377 punonjes (31 Dhjetor 2000: 339 punonjes).

AUTORITETI BANKAR DHE PAGESAVE TE KOSOVES
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PER PERIUDHEN DERI 31 DHJETOR 2001

14. SHPENZIMET E PERGJITHSHME ADMINISTRATIVE

| | 31 Dhjetor 2001 DEM'000 | 15 Nentor , 1999 deri 31 Dhjetor 2000 DEM'000 |
|--|--|--|
| Shpenzime per transportimin e parave dhe te letrave me vlere | 3,276 | 1,346 |
| Mirembajtja dhe riparimi i ndertesave | 258 | 287 |
| Mirembajtja dhe riparimi I mjeteve | 110 | 304 |
| Shpenzime trajnimi per perdorimin e kompjuterave | - | 123 |
| Sherbime te ndryshme | 250 | 64 |
| Sigurimi i transportimin e parave | 357 | 56 |
| Shpenzime komunikimi (telefone, teleks dhe internet) | 160 | 55 |
| Shpenzime kompjuteri | 70 | 53 |
| Shpenzime zyre | 135 | 52 |
| Shpenzime operative per mjetet e transportit | 71 | 44 |
| Licence programesh | 70 | - |
| Shpenzime konsulence dhe auditimi | 334 | - |
| Shpenzime konvertimi ne Euro (shih me poshte) | 769 | - |
| Te tjera | 108 | 65 |
| Totali | 5,968 | 2,449 |

